- Fleksibiliteti EN ISO 24 344, proçedura A.
- Fortesia ISO 7619 - klass: 92 Shore A.
- Rezistenca ne abrazion ISO 4649, proçedura A - klass: 150mm³.
- Ndryshimi ndaj drites artificiale ISO 105-B02, proçedura 3, test cond. 6.1 a -klass: Grey scale ≥level 3 acc. to ISO 105-A 02.
- Klasifikimi ne abrazion EN ISO 10 874 - klass industrial 43.
- Toksifikimi ndaj tymrave te zjarit DIN 53 436 - klass: " Carbonisation gases are non-toxic".
- Vetite antirreshqitese : DIN 53 436/ DIN 51 130/ DIN51 097/ BS 7976 TRRL Pendulum - Klass R9.
- Absorbimi i zhurmave ne ecje: ISO 10 140-3 - klass 8 dB.
- Rezistenca ndaj kimikateve: EN ISO 26 987.
- Konduktiviteti termik: EN 12667 - klass: 0.61 W/mK - Suitable for underfloor heating systems.
- Izolimi elektrik: IEC 60 093, VDE 0303 T.30 - klass 1010.Ohm.
- Efekti i ngarkeses elektrike gjate ecjes: EN 1815- klass: Antistatic, charging in case of rubber soles < 2 kV.
- Efekti i veprimit te kembeve te karikeve: EN 425- klass: Suitable if castor wheels, type W, according to EN 12 529 are used.
- trashesia: 2mm - ne klasa
3mm - ne korridore
- Ngjyrat: RAL 9011 e zeze;
RAL 5002 blu;
RAL 1018 e verdhe;
RAL 7024 gri;
RAL 9003 e bardhe




*reference

4.3.3 Plintusi per dyshemete noraplan PVC VYNAFLEX - 5cm (ose ekuivalent me te)



- Plintus plastik
- rezistent ndaj goditjes.
- Lartesi 60-100mm



4.3.4 Shtrese niveluese llac cemento (screed) Novoment Z3 per dyshemene e ambienteve teknike dhe nenshtrese per dyshemete e tjera specifike (ose ekuivalent me te)

Novoment® Z3 - Llaç çimento me tharje te shpejte - per shtresa dyshemeje.

Fushat e aplikimit:

Novoment®Z3 perdoret per:

- * Per prodhimin e shtresave te dyshemese baze (mbi solete), atyre te lidhura dhe shtresave te dyshemese mbi nje shtrese izoluese (si dhe shtresave te dyshemese me ngrohje).
- * Per perdorim te brendeshem dhe te jashtem, si dhe i pershtatshem per perdorim te drejtperdrejte, si dysheme finale.
- * Per ambiente te ekspozuara ne menyre te vazhdueshme ndaj lageshtise.
- * Per shtresa dyshemeje te lidhura qe jane te mbuluar ne nje faze te hereshme.

Perfitimet:

- * Mund te instalohen pllakat afersisht mbas 3 ditesh, mund te shkelet pas afersisht 1 dite.
- * Mund te punohet dhe lemohet per gati 1 ore. *
- Emetime shume te ulta -GEV-EMICODE EC1 Plus R.
- * I pershtatshem per aplikim me pompe, madje dhe ne temperatura te larta.
- * Rezistent ndaj temperaturave nga -30°C deri ne +80°C, prandaj eshte i pershtatshem per ballkonet, tarracat, garazhet, shtresave me llaç dyshemeje me ngrohje, mbulimin e dyshemeve industriale qe pastrohen me avuj super te nxehte, etj.
- * I pandjeshem nga lageshtia, prandaj eshte i pershtatshem per ambiente te lagura.
- * Klasifikimi i dyshemese: duke ndjekur instruksionet e aplikimit, si shtrese dyshemeje prej çimentoje e klases class CT-C40-F7 , ne perputhje me standartin DIN EN 13813
- Konsumi : 3.4 kg/m²/1cm (rraporti i perzieries me rrere - 1:5 (sipas peshes) ose 1:4 (sipas volumit)

e shtreses :eshte e percaktuar nga agregadet perzjeres - rrera):

Trashesia

1-

Minimum

- * afersisht. 10 mm si dysheme baze te lidhur .
- * afersisht. 35 mm si shtrese dyshemeje standart mbi shtresen izoluese
- * afersisht. 45 mm si shtrese dyshemeje standart si shtrese izoluese.

2- Maximum: afersisht. 160 mm

Paketimi: thes 20 kg

Diametri max. i agregatit (reres)

Ø 4 mm

Ø 8 mm

Ø 16 mm

Trashesia e lejuar e shtreses.

afersisht 10 – 40 mm

afersisht 25 – 80 mm

afersisht ≥ 65 mm

4.3.5 Aditiv special MasterCast 301 per llac cemento (*ose ekuivalent me te*)

Si per shtresen lluster çimento, nen dhe mbi ate hidroizoluese. duhet perdorimi i adetivit special MasterCast 301, aditiv plastifikues i performances se larte.

Sherben per te rritur pershkushmerine e ajrit, fortesine, papershkushmerine ndaj ujit, punushmerine, aftesine lidhese dhe rezistencen ndaj ciklit te ngrije- shkrirjes te llacit.

- Per llacra qe perdoren ne sip. te brendeshme e fasada.
- Per llacra qe perdoren ne suvatime vertikale te mureve te tulles apo gurit, etj, duke rritur punushmerine e tij.
- Rrit rezistencen ndaj depertimit te ujit ne llacra.
- Rrit pershkushmerine e ajrit ne llac.
- Redukton fenomenin e ndarjes se mases te ngurte te llacit nga uji (qe ndodh kur llaci eshte pa aditiv).
- Rrit aftesine lidhese te llacit.
- Permireson dhe rrit vetite punuese te llacit.
- Permireson fortesine e ciklit te ngrirje-shkrirje te llacit.
- Eshte shume ekonomik ne perdorim.

4.3.6 Shtrese me sistemin EP - MasterTop 530 per ambjentet teknike (*ose ekuivalent me te*)

- Eshte nje sistem dyshemeje me baze epoksi



- ka siperfaqe te lemuar qe pastrohet shpejte
- eshte mjaft higjenike
- te perdoret ne ambjentet teknike
- rezistent ndaj abrazionit
- rezistent ndaj ujit, vajerave minerale etj
- aplikohet lehte

4.3.7 DysHEME ME Pllaka gres

Klasifikimi i pllakave bëhet sipas këtyre kriterëve:

- Mënyra e dhënies së formës të pllakës
- Marrja e ujit
- Dimensionet e pllakave
- Vetitë e sipërfaqes
- Veçoritë kimike
- Veçoritë fizike
- Siguria kundër ngricës
- Pësha/ngarkesa e sipërfaqes
- Koeficienti i rrëshqitjes

Tabelat e mëposhtme përshkruajnë disa prej këtyre kriterëve.

Marrja e Ujit në % të masës së pllakës	
Klasa	Marrja e ujit (E)
I	$E < 3 \%$
II a	$3 \% < E < 6 \%$
II b	$6 \% < E < 10 \%$
III	$E > 10 \%$

Klasat e kërkesave/ngarkimit		
Klasa	Ngarkesa	Zona e përdorimit, psh
I	shumë lehtë	Dhoma fjetëse, Banjo
II	e lehtë	Dhoma banuese përveç kuzhinës dhe paradhomes
III	e mesme	Dhoma banuese, ballkone, banjo hotelesh
IV	rëndë	Zyra, paradhoma, dyqane
V	shumë e rëndë	Gastronomi, ndërtesa publike

Pllakat duhen zgjedhur për secilin ambient, duke marrë parasysh nevojat dhe kriteret, që ato duhet t'i përmbushin. Kriteret dhe tabelat e lartpërmendura mund të ndihmojnë në zgjedhjen e tyre.

Për shkolla dhe kopshte, duhet që pllakat të jenë të Klasës V, me sipërfaqe të ashpër, në mënyrë që të sigurojnë një ecje të sigurtë pa rrëshqitje.

Në ambientet me lagështirë (WC, banjo e dushe) duhet të vendosen pllaka të klasës I, që e kanë koeficientin e marrjes së ujit $< 3 \%$.

Për këtë duhet që përpara fillimit të punës, kontraktori të paraqesë tek Supervizori disa shembuj pllakash, së bashku me certifikatën e tyre të prodhimit dhe vetëm pas aprovimit nga ana e tij për shtrimin e tyre, sipas kushteve teknike dhe rekomandimeve të dhëna nga prodhuesi.

4.3.8 Dysheme gome - Ruuber flooring works (*ose ekuivalente me te*)

F.V. Praimer per beton - me baze akrilik copolymer – shume funksional per sip. betoni. Rrezistent ndaj lageshtise.

Ndalon çarjet per shkak humbjes se shpejte te ujit ne sip. betoni
Jep aftesi te larte lidhese me nenbazen.

Nuk permban tretes dhe eshte pa arome-ekologjik. Per te rritur kohen e punushmerise, aftesine lidhese (me nenbazen) dhe minimizimin e bubelzave per shtresat autonivelant ose produkte te ngjashme.

Ne perputhje me Stnd. EN 1504-2

F.N. Shtrese autonivelanti - me baze mbushes mineral dhe Polimere te perforcuara me çimento speciale, ne perputhje me me Standartin EN 13813. Class C20 F5. I pershtateshem per gtrashesi nga 3mm - 10mm.

I perdoreshemper te gjitha llojet e dyshemeve ne supermarketete, shkolla, spitale, ndertesa administrative, hotele, ndertesa banimi, magazine, etj.

I pershtateshem per dysheme me ngrohje nga poshte.

I pershtateshem si nenbaze per dysheme PVC, Gome, Linoleumi, etj,

I pershtateshem si nenbaze per dysheme qeramike, parketi, etj

Krijon sip. te forte dhe pa te çara

F.N. Ngjites per shtresen e gomes - me baze rezine dispersive acrylate te modifikuar. Me emetime shume ulta te gazrave sipas Stnd.: GEV-EMICODE EC 1 PLUS. Ne perputhje me çertifikaten "Blue Angle" - RAL UZ 113. I lire nga SOLVENTET Stnd.. TRGS 610, Giscode D1.

I pershtateshem per dysheme Gome, PVC, etj dhe me nje ngjitje shume te mire me nenbazen.

F.N Shtrese gome me trashesi 3.0mm (kauçuk natyral) - ne perputhje me standartin EN 14 041 . 100% ANTIMIKROBIALE - Certifikae "Blue Angel". Koifiçenti dinamik i ferkimi -Stnd. EN 13 893.

Rrezistenca ndaj zjarit stnd. En 13 501-1 klass:Bfl-s1. Stabiliteti dimensional EN ISO 23 999 - klass.±0.3%. I padjegshem nga cigarja EN 1399. Fleksibiliteti EN ISO 24 344, proçedura A.

Fortesia ISO 7619 - klass: 92 Shore A. Rrezistenca ne abrazion ISO 4649, proçedura A - klass: 150mm³. Ndryshimi ndaj drites artificiale ISO 105-B02, proçedura 3, test cond. 6.1 a -klass: Grey scale ≥level 3 acc. to ISO 105-A 02.

Klasifikimi ne abrazion EN ISO 10 874 - klass industrial 43.

Toksifikimi ndaj tymrave te zjarit DIN 53 436 - klass: " Carbonisation gases are non-toxic".

Vetite antirreshqitese : DIN 53 436/ DIN 51 130/ DIN51 097/ BS 7976 TRRL Pendulum - Klass R9.

Absorbimi i zhurmave ne ecje: ISO 10 140-3 - klass 8 dB. Rrezistenca ndaj kimikateve: EN ISO 26 987. Konduktiviteti termik: EN 12667 - klass: 0.61 W/mK – I pershtateshem per sistemet e ngrohjes nga dyshemeja. Izolimi elektrik: IEC 60 093, VDE 0303 T.30 - klass 1010.Ohm.

Efekti i ngarkeses elektrike gjate ecjes: EN 1815- klass: Antistatic, charging in case of rubber soles < 2 kV. Efekti i veprimit te kembeve te karikeve: EN 425- klass: Suitable if castor wheels, type W, according to EN 12 529 are used.

F.V. Plintus plastik - rezistent ndaj goditjes. Lartesi ~ 60mm

4.3.9 Shtrese moketi FINETT VISION (*ose ekuivalente me te*)

1.a Praimer per beton - me baze akrilik copolymer – shume funksional per sip. betoni. Rrezistent ndaj lageshtise.

Ndalon çarjet per shkak humbjes se shpejte te ujit ne sip. betoni

Jep aftesi te larte lidhese me nenbazen.

Nuk permban tretes dhe eshte pa arome-ekologjik. Per te rritur kohën e punushmerise, aftesine lidhese (me nenbazen) dhe minimizimin e bubelzave per shtresat autonivelant ose produkte te ngjashme.

Ne perputhje me Stnd. EN 1504-2

1.b Shtrese autonivelanti - me baze mbushes mineral dhe Polimere te perforcuara me çimento speciale, ne perputhje me me Standartin EN 13813. Class C30 F6. I pershtateshem per trashesi nga 2mm - 10mm. I perdoreshem

per te gjitha llojet e dyshemeve ne supermarketete, shkolla, spitale, ndertesa administrative, hotele, ndertesa banimi, magazine, etj.

I pershtateshem per dysheme me ngrohje nga poshte.

I pershtateshem si nenbaze per dysheme MOKETI, PVC, Gome, Linoleumi, etj,

I pershtateshem si nenbaze per dysheme qeramike, parketi, etj

Krijon sip. te forte dhe pa te çara

1.c Ngjites per shtresen e moketit - PCI OKL 315 - acrylate dispersion resin-modified, mineral fillers, additives, preservative agents textile flooring. Me emetime shume ulta te gazrave sipas Stnd.: GEV-EMICODE EC 1 PLUS. Ne perputhje me çertifikaten "Blue Angle" - RAL UZ 113. I lire nga SOLVENTET Stnd.. TRGS 610, Giscode D1. I pershtateshem per dysheme MOKETI, etj dhe me nje ngjitje shume te shpejte & mire me nenbazen.

1.d FINETT® Vision color - Shtrese moketi speciale 100% Polyamid dorix® me trashesi 7.0 mm dhe peshe 1700 gr/m² - ne perputhje me standartin EN 14 041 . 100% ANTIMIKROBIALE - ne perputhje me principin DIBt Nr. Z-156.601-401 dhe principit CRI - Green Lapel PLUS 2655. Certifikate "Blue Angel" - RAL-UZ 128. Pjesa e poshteme e moketit - Rrezistenca ndaj zjarrit stnd. En 13 501-1 klass:Bfl-s1. Peshë e fijeve: 800 gr/m² - Peshë e fijeve te shtreses veshese: 750 gr/m². Impakti i zeizolimit ISO 10140 - 25 dB. Niveli i zeabsorbimit ISO 354 - Freq. Hz 500-5000 dhe αS - 0.10 - 0.80. Colour fastness to light ISO 105-B02: 7. Rezistenca termike ISO 8302: 0,09 m² K/W e pershtateshme per sistemet e nrohjeve nga dyshemeja. Anti-Static ISO 6356: ≤ 2,0 kV. Niveli i perdorimit EN 1307 - CLASS 33 HEAVY DUTY. I çertifikuar nga: GERMAN SUSTAINABLE BUILDING CUNCIL.

4.3.10 Shtrese gifafloor ne sallën e teatrit të kukullave (ose ekuivalente me të)



Me dimension 1200x600 mm ose 600x600 mm, trashësia 25,28,32 dhe 38 mm, ulluku rrethues.

Avantazhe:

- Rezistence ndaj trafikut të lartë
- A1 (sipas të EN 13501-1)
- Kohe e shkurtër e instalimit
- I përshtatshëm për dysheme të thata teknike dhe sistemet me shtrirje lineare
- Elemente me dendësi të lartë të fibrave të gipsit
- Elemente mbyllesë anësore me fortesë të lartë
- Cilesi e lartë
- Shpejteshi e lartë e shtrimit
- E shpejtë dhe e thjeshtë për të shtruar
- Për përdorim të brendshëm

KAPITULLI 5
BETONET

5.1 Te pergjithshme

Puna e mbuluar nga ky seksion i specifikimeve konsiston ne furnizimin e gjithe kantierit, punen, pajisjet, veglat dhe materialet, dhe kryerjen e te gjitha punimeve, ne lidhje me hedhjen, kujdesin, perfundimin e punes se betonit dhe hekurin e armimit ne perputhje rigoroze me kete kapitull te specifikimeve dhe projekt zbatimin.

Ne fillim te Kontrates Sipermarresi duhet te paraqese per miratim tek Mbikqyresi i Punimeve nje njoftim per metodat duke detajuar, ne lidhje me kerkesat e ketyre Specifikimeve, propozimet e tij per organizimin e aktiviteteve te betonimit ne shesh (teren). Njoftimi i metodave do te perfshije ceshtjet e meposhtme:

1. Njesia e prodhimit e propozuar
2. Vendorsja dhe shtrirja e paisjeve te prodhimit te betonit
3. Metodrat e propozuara per organizimin e paisjeve te prodhimit te betonit
4. Procedurat e kontrollit te cilesise se betonit dhe materialeve te betonit
5. Transporti dhe hedhja e betonit
6. Detaje te punes se berjes se kallepeve duke perfshire kohen e heqjes se kallepeve dhe procedurat per mbeshtetjen e perkohshme te trareve dhe te soletave.

5.2 Kontrolli i cilesise

Sipermarresi do te punesoje inxhinier te kualifikuar, te specializuar dhe me eksperience, i cili do te jete pergjegjes per kontrollin e cilesise te te gjitha betonit. Materialet dhe mjeshteria e perdorur ne punimet e betonit duhet te jete e nje cilesie sa me te larte qe te jete e mundur, prandaj vetem personel me eksperience dhe aftesi te plote ne kete kategori punimesh do te punohesohet per punen qe perfshin ky seksion specifikimesh.

5.3 Puna pergatitore dhe inspektimi

Perpara se te jete kryer ndonje proces i pergatitjes se llacit ose betonit, zona brenda armaturave (ose siperfaqe te tjera sipas zbatimit) duhet te jete pastruar shume mire me uje ose me ajer te komprimuar. Cfare do qe ka te beje me kete proces duhet te pergatitet sic eshte specifikuar.

Asnje proces betonimi nuk duhet te kryhet derisa Mbikqyresi i Punimeve te kete inspektuar dhe aprovuar (ne se eshte e mundur) germimin, masat e marra per mbrojtjen nga kushtet atmosferike, masat per shperndarjen e ujit per freskim dhe staxhionim, armaturat, ndalimin e ujit, fugat ndertimore dhe fiksimin e fundeve dhe masa te tjera, armimin dhe ceshtje te tjera qe duhet te fiksohen, si dhe te gjitha materialet e tjera per betonimin dhe masa te tjera ne pergjithesi. Sipermarresi duhet t'i jape Mbikqyresit te Punimeve njoftime te arsyeshme per te bere te mundur qe ky inspektim te kryhet.

5.5 Materialet

Çimento

a. Çimento Portland e Zakonshme do te perdoret me BS 12 ose ASTM C-150 Tipi II- te ose Tipi V-te. Kjo do te perdoret aty ku betoni nuk eshte ne kontakt me ujera te zeza, tub gazi ose ujerat nentokesore.

b. Çimento Portland Sulfate e Rezistueshme do te perdoret me BS 4027. Kjo do te perdoret per strukturat e betoneve duke perfshire pusetat dhe te gjitha perkatesite e tjera ne kontakt me ujerat e zeza, tubin e gazit ose ujerat nentokesore.

Çimento duhet te shperndahet ne paketa origjinale te shenuara te pa demtuara direkt nga fabrika dhe duhet te ruhet ne nje depo, dyshemeja e te cilit duhet te jete e ngritur te pakten 150mm nga toka. Nje sasi e mjaftueshme duhet mbajtur rezerve per te siguruar nje furnizim te vazhdueshem ne pune, ne menyre qe te sigurohet qe dergesat e ndryshme jane perdorur ne ate menyre sic jane shperndare. Çimentoja nuk duhet ruajtur ne kantier per me shume se tre muaj pa lejen e Mbikqyresit te Punimeve. Çdo lloj tjetër cimento, pervec asaj qe eshte e parashikuar per perdorimin ne pune nuk duhet ruajtur ne depo te tilla. E gjithë cimentoja duhet mbajtur e ajrosur mire dhe cdo lloj cimento, e cila ka filluar te ngurtesohet, ose ndryshe e demtuar apo e keqesuar nuk duhet te perdoret. Fletet e analizave te fabrikave duhet te shoqerohje cdo dergese duke vertetuar qe cimentoja, e cila shperndahet ne shesh ka qene e testuar dhe i ka plotesuar kerkesat e permendura me lart. Me te mberitur, certifikatat e provave te tilla duhen ti kalohen per t'i aprovuar Mbikqyresit te Punimeve. Çimentoja e perfituar nga pastrimi i thaseve te çimentos ose nga pastrimi i dyshemese nuk do te perdoret. Kur udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve, çimento e dyshimte duhet te riestohet per humbjen e fortesise ne ngjeshje.

Inertet

Te pergjithshme

Me perjashtim te asaj qe eshte modifikuar ketu, inertet (te imta dhe te trasha) per te gjitha tipet e betonit duhet te perdoren duke respektuar STASH-512-78 (Standarti Shqiptar) ose ne perputhje me ASTM C 33 "Inertet e betonit nga burime natyrale". Ato duhet te jene te forte dhe te qendrueshem dhe nuk duhet te permbajne materiale te demshme qe veprojne kunder fortesise ose qendrueshmerise se betonit ose, ne rast te betonarmese mund te shkatërrojte kete perforcim.

Materialet e perdorura si inerte duhet te perftohen nga burimet te njohura per te arritur rezultate te kenaqshme per klasa te ndryshme te betonit. Nuk do te lejohet perdorimi i inerteve nga burime, te cilat nuk jane te aprovuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

Inertet e imta

Inertet e imta per kategorite e betonit A, B dhe C (respektivisht M100, M200, M2500) konform STASH 512-78, do te jene prej rere natyrale, gure te shoshitur, ose materiale te tjera inerte me te njejtat karakteristika apo kombinim te tyre. E gjitha kjo duhet te jete pastruar shume mire, pa masa te mpiksura, cifla te buta e te vecanta, vajra distilimi, alkale, lende organike, argjile dhe sasi te substancave te demtuese.

Permbajtja maksimale e lejueshme e lymit dhe substancave te tjera demtuese eshte 5%. Materialet e marra nga gure te papershtashem per inerte te trasha nuk duhet te perdoren si inerte te imta. Inertet e imta te marra nga guret e shoshitur duhet te jene te mprehte, kubike, te forte, te dendur dhe te durueshem dhe duhet te grumbullohen ne nje platforme per te patur nje mbrojtje te mjaftueshme nga pluhurat dhe perzierjet e tjera. Shkalla e shperndarjes per inertet e imeta te specifikuara si me lart, duhet te jene

brenda kufijve te meposhtem, te percaktuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

Masa e Sites	Perqindja qe kalon (peshe e thate)
10.00mm	100
5.00mm	89 ne 100
2.36mm	60 ne 100
1.18mm	30 ne 100
0.60mm (600 um)	15 ne 100
0.30mm (300 um)	5 ne 70
0.15mm (150 um)	0 ne 15

Inertet e imeta per kategorine D te betonit duhet te jene te nje cilesie te mire nga rera e brigjeve. Ajo duhet te jete pastruar nga materialet natyrale e klasifikuar nga me e holla deri tek me e trasha, pa copeza, nga argjila, zgjyra, hirera, plehra dhe cifla te tjera. Nuk duhet te permbaje me shume se 10% te materialit me te holle se 0.10mm (100um) te hapesires ne rrjete, jo me shume se 5% te pjeses se mbetur ne 2.36mm site; i gjithë materiali duhet te kaloje neper nje rrjete 10mm.

Inertet e trasha

Inertet e trasha per kategorite e betonit A, B dhe C do te perbehen nga materiale guri te thyer apo te nxjere ose nje kombinim i tyre, me nje mase jo me shume se 20 mm, dhe do te jene te paster, te forte, te qendrueshem, kubik dhe te formuar mire, pa lende te buta apo te thermueshme, ose copeza te holla te stergjatura, alkale, lende organike ose masa apo substanca te tjera te demshme. Lendet demtuese ne inerte nuk duhet te kalojne me shume se 3 %. Klasifikimi per inertet e trasha te specifikuara sa me siper duhet te jete brenda kufijve te meposhtem:

Masa e sites	Perqindja e kalimit (ne peshe te thate)
50.0 mm	100
37.5 mm	90 ne 100
20.0 mm	35 ne 70
10.0 mm	10 ne 40
5.0 mm	0 ne 5

Inertet e trasha per kategorine D te betonit duhet te jene tulla te thyera te prodhuara prej tullave te cilesise se pare ose grumbulli i tyre, ose nga tulla te mbipjekura. Nuk do te thyhen per perdorim per inerte te imta as tullat e papjekura apo grumbulli i tyre dhe as ato qe jane bere porose gjate procesit te pjekjes. Agregati me tulla te thyera nuk duhet te permbaje gjethe, kashte dhe, rere ose materiale te tjera te huaja dhe ose mbeturina te tjera. Inertet prej tullave te thyera duhet te jene te nje diametri 25-40 mm dhe nuk duhet te permbajne asgje qe te kaloje nepermjet sites 2.36 mm.

Raportet e inerteve te trasha dhe te imta

Raporti me i pershtatshem i volumit te inerteve te trasha ne volumen e inerteve te imta duhet te vendoset nga prova e ngjeshjes se kubikeve te betonit, por Mbikqyresi i Punimeve mund te urdheroje qe keto raporte te ndryshojne lehtesisht sipas klasifikimit te inerteve ose sipas

peshes ne se do te jete e nevojshme, ne menyre qe te prodhohen klasifikimet e duhura per perzjerjet e inerteve te trasha dhe te holla. Sipermarresi duhet te beje disa prova ne kubiket e marre si kampione dhe te shenoje inertet dhe fraksionimin e tyre, perzjerjen e betonit ne fillim te punes dhe kur ka ndonje ndryshim ne inertet e imeta apo te trasha ose ne burimin e tyre te furnizimit. Keta kubike duhet te testohen ne laborator ne kushte te njejta, pervec rasteve te ndryshimeve te vogla ne raportet perkatese te inerteve te imta dhe te trasha (lart apo poshte) nga raporti me i mire i arritur nga analizat e sites. Kubiket duhet te testohen nga 7 deri 28 dite. Nga rezultatet e ketyre provave (testeve) Mbikqyresi i Punimeve mund te vendose per raportet e trashesise se inerteve te imta qe duhet te perdoren per cdo perzjerje te mevoneshme gjate zhvillimit te punes ose deri sa te kete ndonje ndryshim ne inerte.

Shperndarja

Ne kantier nuk do te sillen inerte per tu perdorur derisa Mbikqyresi i Punimeve te kete aprovuar inertet per tu perdorur dhe masat per larjen, etj. Me tej nga Sipermarresi do te merren kampione ne cdo 75m³ nen mbikqyrjen e Mbikqyresit te Punimeve, per cdo tip inertit te shperndare ne kantier (teren) dhe te dorezuar perfaqesuesit te Mbikqyresit te Punimeve per provat e kontroleve te zakonshme. Kosto e te gjitha testeve do te mbulohet nga Sipermarresi.

Ruajtja e materialit te betonit

Çimento dhe inertet duhet te mbrohen ne cdo kohe nga demtuesit dhe ndotjet. Sipermarresi duhet te siguroje nje kontener apo ndertese per ruajtjen e cimentos ne shesh. Ndertesa ose konteneri duhet te jete e thate dhe me ventilim te pershtatshem. Ne se do te perdoret me shume se nje lloj cimentoje ne punime, konteneri apo ndertesa duhet te jete e ndare ne nendarje te pershtatshme sipas kerkesave te Mbikqyresit te Punimeve si dhe duhet ushtruar kujdes i madh qe tipe te ndryshme cimentoje te mos jene ne kontakt me njera tjetren.

Thaset e cimentos nuk duhet te lihen direkt mbi dysheme, por mbi shtresa druri apo pjese te ngritur trotuari per te lejuar keshtu qarkullimin efektiv te ajrit rreth e qark thaseve.

Çimentoja nuk duhet te mbahet ne nje magazine te perkohshme, pervec rasteve kur eshte e nevojshme per organizimin efektiv te perzjeres dhe vetem kur eshte marre aprovimi i meparshem i Mbikqyresit te Punimeve.

Agregati duhet te ruhen ne kantier ne hambare ose platforma betoni te padepertueshme te pergatitura posacerisht, ne menyre qe fraksione te ndryshme inertesh te mbahen te ndara per gjithe kohen ne menyre qe perzierja e tyre te ulet ne minimum.

Sipermarresit mund t'i kerkohej te kryeje ne kantier procese shtese dhe/ose larje efektive te inerteve atehere kur sipas Mbikqyresit te Punimeve ky veprim eshte i nevojshem per te siguruar qe te gjitha inertet plotesojne kerkesat e specifikimeve ne kohen kur materialet e betonit jane perzjere. Mbikqyresi i Punimeve do te aprovoje metodat e perdorura per pergatitjen dhe larjen e inerteve.

Uji per cemento

Uji i perdorur per beton duhet te jete i paster, i fresket dhe pa balte, papasteri organike vegjetale dhe pa kripera dhe substanca te tjera qe nderhyjne ose demtojne forcen apo durueshmerine e betonit. Uji duhet te sigurohet mundesisht nga furnizime publike dhe mund te merret nga

burime të tjera vetëm nëse aprovohet nga Mbikqyesi i Punimeve. Nuk duhet të përdoret asnjëherë ujë nga germimet, kullimet sipërfaqësore apo kanalet e vaditjes. Vetëm ujë i aprovuar nga ana cilësore duhet të përdoret për larjen e pastrimin e armaturave, kujdesin e betonit si dhe për qëllime të ngjashme.

5.6 Kerkesat për perzjerjen e betonit

Fortesia

Klasifikimet i referohen raporteve të cimentos, inertve të imta dhe inerteve të trasha. Kerkesat për perzjerjen e betonit duhet të konsistojnë në ndarjen proporcionale dhe perzjerjen për fortesite e mëposhtme kur behen testet e kubikeve;

<u>Klasa e betonit</u>	<u>Fortesia në shtypje</u>	
	<u>në N/mm² (NEWTON/mm²)</u>	
	<u>7 dite</u>	<u>28 dite</u>
Klasa A&A (M100) (s)1:1,5:3	17.00	25.50
Klasa B&B (M200) (s)1:2:4	14.00	21.00
Klasa C&C (M250) (s)1:3:6	6.50	10.00
Klasa D&D (M300) (s)1:6:12	Me pelqimin e Menaxherit të Projektit	

Shënim. (s) = Çimento sulfatë e rezistueshme.

Raporti ujë-cimento

Raporti ujë-cimento është raport i peshës së cimentos në të. Përbajtja e ujit duhet të jetë efiçase për të prodhuar një perzjerje të punueshme të fortesisë së specifikuar, por përbajtja totale e ujit duhet të përcaktohet nga tabela e mëposhtme:

<u>Klasa e betonit</u>	<u>Max. i ujit të lirë/raporti cimento</u>
Klasa A&A (M100) (s)1:1,5:3	0.5
Klasa B&B (M200) (s)1:2:4	0.6
Klasa C&C (M250) (s)1:3:6	0.65
Klasa D&D (M300) (s)1:6:12	Me pelqimin e Mbikqyresit të Punimeve

Shënim. (s) = Çimento sulfatë e rezistueshme.

Qendrueshmeria

Raportet e perberësve duhet të jenë të ndryshëm për të siguruar qendrueshmerinë e dëshëruar të betonit kur provohet (testohet), në përshatje me kerkesat e mëposhtme ose sipas urdherave të Mbikqyresit të Punimeve.

<u>Perdorimet e betonit</u>	<u>Min&Max (mm)</u>
Seksionet normale të forcuara të ngjeshura me vibrime, ngjeshja me	25 në 75

dore e mases se betonit

Seksione prej betonarmeje te renda 50 ne 100 te ngjeshura
me vibracion, beton i ngjeshur
me dore ne pllaka te perforcuara normalisht, trare,
kollona dhe mure.

Ne te gjitha rastet, raportet e agregatit ne beton duhet te jene te tilla qe te prodhohen perzjerje te cilat do futen neper qoshe edhe cepa te formave si dhe perreth perforcimit pa lejuar ndarjen e materialeve.

5.7 Matja e materialeve

Inertet e imeta dhe te trasha do te peshohen ose te maten me kujdes ne pershtatje me kerkesat e Manaxheri te Projektit. Ato nuk do te maten ne asnje rast me lopata apo karroca dore. Cemento do te matet me thase 50 kg dhe masa e perzjerjes do te jete e tille qe grumbulli i materialeve te pershtatet per nje ose me shume thase.

5.8 Metodat e perzjerjes

Betoni duhet te perzjehet ne perzjeresa mekanike te miratuar qe me pare. Perzjersi, hinka dhe pjesa perpunuese e tij duhet te jene te mbrojtura nga shiu dhe era.

Inertet dhe cemento duhet te perzjehen se bashku para se te shtohet uje derisa persjerja te fitoje ngjyren dhe fortesine e duhur. Duhet te largohen papastertirat dhe substancat e tjera te padeshirueshme. Uji nuk duhet te shtohet nga zorra apo rezervuare ne menyre te pakujdesshme. i gjithe betoni duhet te perzihet uniformisht ne fabrika moderne perzjerjeje per prodhimin maximal te betonit te nevojshem per plotesimin e punes brenda kohes se percaktuar pa zvogeluar kohen e nevojshme per perzjerje. Betoni duhet te perzjehet ne perzjeresa betoni per kohezgjatjen e kerkuar per shperndarjen uniforme te perberesve per te prodhuar nje mase homogjene me ngjyre dhe fortesi por jo me pak se 1-1/2 minute. Perzjeresi duhet te perdoret nga punetore te specializuar qe kane eksperience te meparshme ne drejtimin e perdorimin e perzjeresit te betonit.

Me mbarimin e kohes se perzjerjes, perzjeresi dhe te gjitha mjetet e perdorura do te pastrohen mire perpara se betoni i mbetur ne to te kete kohe te forcohet.

Ne asnje menyre nuk duhet qe betoni te perzjehet me dore pa miratimin e Mbikqyresit te Punimeve, miratim ky qe do te jepet vetem per sasi te vogla ne kushte te vecanta.

5.9 Provat e fortesise gjate punes.

Sipermarresi duhet te siguroje per qellimet e provave nje set 3 kubikesh per cdo strukture betoni, perfshire derdhje betoni nga 1-15 m³. Per derdhje betoni me shume se 15 m³, Sipermarresi duhet te siguroje te pakten nje set shtese 3 kubikesh per cdo 30 m³ shtese. Ne se mesatarja e proves se fortesise se kampionit per cdo porcion te punes bie poshte minimumit te lejueshem te fortesise se specifikuar, Mbikqyresi i Punimeve do te udhezaje nje ndryshim ne raportet ose permbajtjen e ujit ne beton, ose te dyja, ne menyre qe Punedhenesi te mos kete shtese kostoje. Sipermarresi duhet

te percaktoje te gjitha kampionet qe kane te bejne me raportet e betonimit prej nga ku jane marre. Nese rezultatet e testeve te fortesise mbas kontrollit te specimentit tregojne se betoni i perftuar nuk i ploteson kerkesat e specifikuara ose kur ka prova te tjera qe tregojne se cilesia e betonit eshte nen nivelin e kerkesave te specifiuara, betoni ne vendin, qe perfaqeson kampioni do te refuzohet nga Mbikqyresi i Punimeve dhe Sipermarresi do ta levize dhe ta rivendose masen e kthyer te betonit mbrapsh me shpenzimet e veta. Sipermarresi do te mbuloje shpenzimet e te gjitha provave qe do te behen ne nje laborator qe eshte aprovuar Punedhesisit.

5.10 Transportimi i betonit

Betoni duhet te levizet nga vendi i pergatitjes ne vendin e vendosjes perfundimtare sa me shpejt ne menyre qe te pengohet ndarja ose humbja e ndonje perberesi.

Kur te jete e mundshme, betoni do te derdhet nga perzjeresi direkt ne nje paisje qe do te beje transportimin ne destinacionin perfundimtar dhe betoni do te shkarkohet ne menyre aq te mbledhur sa te jete e mundur ne vendin perfundimtar per te shmangur shperndarjen ose derdhjen e tij.

Ne se Sipermarresi propozon te perdore pompa per transportimin dhe vendosjen e betonit, ai duhet te paraqese detaje te plota per paisjet dhe tekniken e perdorimit qe ai propozon per te perdorur per tu miratuar tek Mbikqyresi i Punimeve.

Ne rastet kur betoni transportohet me rreshqitje apo me pompa, kantieri qe do te perdoret, duhet te projektohet per te siguruar rrjedhjen e vashdushme dhe te panderprere ne rrepre apo gryke (hinke). Fundi i pjerresise ose i pompes se shperndarjes duhet te jete i mbushur me uje para dhe pas cdo periudhe pune dhe duhet te mbahet paster. Uji i perdorur per kete qellim, duhet te largohet (derdhet) nga cdo ambjent pune i perhershem.

5.11 Hedhja dhe ngjeshja e betonit

Sipermarresi duhet te kete aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve per masat e propozuara perpara se te filloje betonimin.

Te gjitha vendet e hedhjes dhe te ngjeshjes se betonit, duhet te mbahen ne mbikqyrje te vazhdueshme nga pjesetaret perkates te ekipit te Sipermarresit. Sipermarresi duhet te ndjeke nga afer ngjeshjen e betonit, si nje pune me rendesi te madhe, objekt i te cilit do te jete prodhimi i nje betoni te papershkushem nga uji me nje densitet dhe fortesi maximale.

Pasi te jete perzjere, betoni duhet te transportohet ne vendin e tij te punes sa me shpejt qe te jete e mundur, i ngjeshur mire ne vendin rreth perforcimit, i perzjere sic duhet me lopate me mjete te pershtatshme celiku per kallepe duke siguruar nje siperfaqe te mire dhe beton te dendur, pa vrime, dhe i ngjeshur mire per te sjelle uje ne siperfaqe dhe per te ndaluar xhepat e ajrit. Armatura duhet te jete e hapur ne menyre te tille qe te lejoje daljen e bulezave te ajrit, dhe betoni duhet te vibrohet me cdo kusht me mekanizma vibruese per ta bere ate te dendur, aty ku eshte e nevojshme. Betoni duhet te hidhet sa eshte i fresket dhe para se te kete fituar qendrueshmerine fillestare, dhe ne cdo rast jo me vone se 30 minuta pas perzjerjes.

Metoda e transportimit te betonit nga perzjeresi ne vendin e tij te punes duhet te aprovohet nga Mbikqyresi i Punimeve.

Nuk do të lejohet asnjë metode që nxit ndarjen apo vecimin e pjeseve të trasha dhe të holla, apo që lejohen derdhjen e betonit lirisht nga një lartësi më e madhe se 1.5m. Kur hedhja e betonit ndërpritet, betoni nuk duhet në asnjë mënyrë të lejohet të formojë skaje apo ane, por duhet të ndalohet dhe të forcohet mirë në një ndalesë të ndërtuar posacerisht dhe të formuar mirë për të krijuar një bashkim konstruktiv efikas, që është në përgjithësi, në qoshtet e djathta drejt armatimit kryesor. Pozicioni dhe projekti i fugave të tilla, duhet të aprovohen nga Mbikqyresi i Punimeve. Menjehere para se të hidhet betoni tjetër, sipërfaqet e të gjitha fugave duhet të kontrollohen, të pastrohen me furçe dhe të lahen me llaç të pastër. Është e keshillueshme që ashpersia e betonit të jetë arritur kur ngjyra bëhet gri dhe të mos lihet derisa të forcohet.

Para se betoni të hidhet në ose kundërt një germimi, ky germim duhet të jetë i forcuar dhe pa ujë të rrjedhshëm apo të ndenjtur, vaj dhe lende të demshme. Balta e qullet dhe materialet e tjera dhe në rast germimi guresh, copesa dhe thermija do të hiqen. Gropa duhet të jetë e qullet por jo e lagur dhe duhet të ndermerren masa paraprake për të parandaluar ujërat nënetokesore që të demtojnë betonin e pa hedhur ose të shkaktojnë levizjen e betonit.

Aty ku është e nevojshme apo e kërkuar nga Mbikqyresi i Punimeve, betoni duhet të vibrohet gjatë hedhjes me vibratorë të brendshëm, të afta për të prodhuar vibrime jo më pak se 5000 cikle për minutë. Sipermarresi duhet të tregojë kujdes për të shmangur kontaktin midis vibratorëve dhe perforcimit, dhe të evitohet vecimin e inerteve nga vibrimi i tepert. Vibratorët duhet të vendosen vertikalisht në beton 500 mm larg dhe të terhiqen gradualisht kur flluckat e ajrit nuk dalin më në sipërfaqe. Nqs, në vazhdim, shtypja është aplikuar jashtë armatures, duhet të kihet kujdes i madh që të shmangët demtimi i betonarmesë.

Kur betoni vendoset në ndalesa horizontale ose të pjerrëta të kalimit të ujit, kjo e fundit duhet të zhvendoset duke i lënë vendin betonit që duhet të ngjeshet në një nivel pak më të lartë se fundi i ndalesës së ujit para se të leshohet uji për të siguruar ngjeshje të plote të betonit rreth ndalesës së ujit.

5.12 Betonim në kohë të nxehtë

Sipermarresi duhet të tregojë kujdes gjatë motit të nxehtë për të parandaluar carjen apo plasaritjen e betonit. Aty ku është e realizueshme, Sipermarresi duhet të marrë masa që betoni të hidhet në mëngjes ose natën vone.

Sipermarresi duhet të ketë kujdes të veçantë për kërkesat e specifiuara këtu për kujdesin. Kallepet duhet të mbulohen nga ekspozimi direkt në diell si para vendosjes së betonit, ashtu edhe gjatë hedhjes dhe vendosjes. Sipermarresi duhet të marrë masa të pershtatshme për të siguruar që armimi dhe hedhja e masës për tu betonuar është mbajtur në temperaturat më të ulëta të zbatueshme.

5.13 Kujdesi për betonin

Vetëm neqoftese është përcaktuar apo urdheruar ndryshe nga Mbikqyresi i Punimeve, të gjitha betonet do të ndiqen me kujdes si më poshtë:

1. Sipërfaqe betoni horizontale: do të mbahet e lagët vashdimisht për të pakten 7 dite pas hedhjes. Ato do të mbulohen me materiale ujë mbajtes si thasë kerpi, pelhure, rere e pastër ose rrogos ose metoda të tjera të miratuara nga Mbikqyresi i Punimeve.
2. Sipërfaqe vertikale: do të kujdesen fillimisht duke lënë armaturat në vend pa levizur, duke

varur pelhure ose thase kerpi mbi siperfaqen e perfunduar dhe duke e mbajtur vazhdimisht te laget ose duke e mbuluar me plasmas.

5.14 Forcimi i betonit

Me perfundimin e germimit dhe aty ku tregohet ne vizatimet ose urdherohet nga Mbikqyresi i Punimeve, nje shtrese forcuese betoni e kategorise D jo me pak se 75 mm e trashe ose e thelle do te vendoset per te parandaluar shperberjen e mases dhe per te formuar nje siperfaqe te paster pune per strukturen.

5.15 Hekuri i armimit

Shufrat e armimit duhet te kthehen sipas masave dhe dimensioneve te vizatimeve, dhe ne perputhje te plote me rregulloren e, rishikuar se fundi te ASTM, shenimi A-615 me titullin "Specifikimet per shufrat e hekurit per betonarme". Ato duhet te perkulen ne perputhje me vizatimet e ASTM A-305, Celik 3 me sigma te rrjedhshmerise 250 kg/cm^2 .

Hekuri i armimit duhet te jete pa njolla, ndryshk, mbeturina te mullijve, bojera, vajra, graso, dherave ngjitese ose ndonje material tjetër qe mund te demtoje lidhjen midis betonit dhe armimit ose qe mund te shkaktoje korrozion te armimit ose shperberje te betonit. Çimento per suva nuk duhet te lejohet. As madhesia dhe as gjatesia e shufrave nuk duhet te jene me pak se madhesia ose gjatesia e treguar ne vizatime.

Shufrat duhet te perkulen gjithmone ne te ftohte. Shufrat e perkulura jo sic duhet do te perdoren vetem ne se mjetet e perdorura per drejtimin dhe riperkuljen te jene te tilla qe te mos demtoje materialin. Asnje armim nuk do te perkulet ne pozita pune pa aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve, ne se eshte ngulur ne betonin e forcuar. Rrezja e brendeshme e perkuljeve nuk duhet te jete me e vogel se dyfishi i diametrit te shufrave per hekur te bute dhe trefishi i diametrit te shufres per hekur shume elastik.

Armimi duhet te behet me shume kujdes dhe te mbahet nga paisjet e miratuara ne pozicionin e paraqitura ne skica. Shufrat qe jane parashikuar te jene ne kontakt duhet te lidhen se bashku me siguri te larte ne te gjitha pikat e kryqezimit me tel te kalitur hekuri te bute me diameter.No.16. Kordonat lidhes dhe te tjeret si keto duhet te lidhen fort me shufrat me te cilat jane parashikuar te jene ne kontakt dhe pervec kesaj duhet te lidhen ne menyre te sigurte me tel. Menjehere para betonimit, armimi duhet te kontrollohet per saktesi vendosjeje dhe pastertie dhe do te korigjohet ne se eshte e nevojshme.

Spesoret duhet te jene prej llaci me cimento dhe rere 1:2 ose materiale te tjera te miratuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

Sipermarresi duhet te pershtase masa efektive per te siguruar qe perforcimi te qendroje i palevizur gjate forcimit te mases se hedhur dhe vendosjes se betonit.

Ne soletat e dhena me dy ose me shume shtresa perforcimi, shtresat paralele te hekurit duhet te mbeshteten ne pozicion me ndihmen e mbajteseve prej hekuri. Spesoret vendosen ne cdo mbajtese per te mbeshtetur shtresat e armimit nga forcimi ose armatura.

Pervec se kur tregohet ndryshe ne skica, gjatesia e nyjeve bashkuese duhet te jete jo me pak se 40 here e diametrit te shufres me diameter me te madh.

Armimet e ndertuara kur shtrohen perbri seksioneve te tjera te armimit ose kur xhunohen, duhet te kene nje minimum xhuntimi prej 300mm per shufrat kryesore dhe 150 mm per shufrat e terthorta. Perdorimi i mbeturinave te prera nuk do te lejohet.

Pervec se kur eshte specifiuar apo treguar ndryshe ne skica, mbulimi i betonit ne perforcimin me te afert duke perjashtuar suvane ose punime te tjera dekorative dhe forcim betoni, do te jete si me poshte:

1. Per pune te jashtme dhe per pune ne siperfaqe toke dhe ne struktura ujembajtese - 50mm
2. Per pune te brendeshme ne struktura joujembajtese:
 - a) per trare dhe kolona-50mm ne hekurin kryesor dhe ne asnje vend me pak se 40mm ne shufren me afer murit te jashtem
 - b) per forcimin e soletave-25mm per te gjitha shufrat ose diametri i shufres me te madhe, ciladoqofte me e madhja.

Prerja, perkulja dhe vendosja e armimit do te jete pjese e punes brenda cmimit njesi te vendosura ne Oferten e tenderit per armimin e hekurit te furnizuar dhe te vene ne pune.

Projektimi i armimit nga puna qe eshte duke u realizuar ose e realizuar tashme, nuk do te kthehet ne pozicionin e sakte vetem ne rast se eshte miratuar nga Mbikqyresi i Punimeve dhe do te mbrohet nga deformimi ose demtime te tjera. Saldimi i shufrave te perforcuara me perjashtim te rasteve te shufrave te fabrikua me saldime nuk do te lejohet. Shufrat e perforcuara te ekspozuara per shtesa te ardhshme, do te mbrohen nga korrozioni dhe rrezique te tjera.

5.16 Kallepet ose armaturat

Armaturat ose kallepet duhet te jene ne pershtatje me profilet, linjat dhe dimensionet e betonimit te percaktuara ne skica, te fiksuara apo te mbeshtetura me pyka apo mjete te ngjashme per te lejuar qe ngarkimi te jet i lehte dhe format te levizen pa demtime dhe pa goditje ne vendin e punes.

Furnizimi, fiksimi dhe levizja e kallepeve duhet te jete pjese e punes brenda cmimit njesi te paraqitur ne Oferten e tenderit per kategori te ndryshme te betonit te furnizuar dhe te hedhur ne pune.

Kallepi duhet te ndertohet me vija qe mbyllen lehtesisht per largimin e ujit, materialeve te demshme dhe per qellime inspektimi, si dhe me lidhesa per te lehtesuar shkeputjen pa demtuar betonin. Te gjitha mbeshteteset vertikale duhet te jene te vendosura ne menyre te tille qe mund te ulen dhe kallepi te shkeputet lehte ne goditje apo sheputje. Kallepe per traret duhet te montohen me nje pjese ngritese

6mm per cdo 3m shtrirje.

Metodat e fiksimit te kallepit faqe te ekspozuara te betonit nuk duhet te perfshijne ndonje lloj fiksusi ne beton ne menyre qe te kemi siperfaqe te sheshte betoni. Asnje bulon, tel apo ndonje mjet tjeter perdorur per qellime fiksimit te kallepeve apo armimit nuk duhet te perdoret ne betonim i cili do te jete i papershkueshem nga uji. Lidhjet e perhershme metalike dhe spesoret nuk duhet te kene pjese te tyre fiksuse si te perhershme Brenda 50 mm te siperfaqes se perfunduar te betonit, dhe ndonje vrime e lene ne faqet e betonit e paekspozuar duhet qe te mbyllet permes nje suvatimi me llac cemento te forte 1:2.

Nje tolerance prej 3mm ne rritje ne nivel do te lejohet ne ngritjen e kallepit i cili duhet te jete i forte, rigjid perkundrejt betoneve te laget, vibrimeve dhe ngarkesave te ndertimit dhe duhet te mbetet ne pershtatje te plote me skicen dhe nivelin e pranuar perpara betonimit. Ajo duhet te jete sic duhet i papershkueshem nga uji qe te siguroje qe nuk do te ndodhin "disekuilibra" ose largimin e llacit per ne bashkimet, ose te lengut nga betoni.

Te gjitha qoshet e jashtme te betonit qe nuk jane vendosur pergjithmone ne toke duhet tu jepet 18mm kanal, pervec aty ku tregohet ndryshe ne vizatimet.

Tubat, tubat fleksibel (per linjat elektrike) dhe mjetet e tjera per fiksimin dhe konet ose te tjera pajisje per formimin e vrimave, kanaleve, ulluqeve etj, duhet qe te fiksohen ne menyre rigjide ne armaturat dhe aprovimi i Mbikqyresit te Punimeve do te kerkohet perpara.

Druri (derrasa) i armaturave nuk duhet te deformohen kur te lagen. Per siperfaqe te paeksponuara dhe punime jo fine, mund te perdoret derrase armature e palemuar. Ne te gjitha rastet e tjera siperfaqja ne kontakt me betonin duhet te jete e lemuar (zduguar). Druri duhet te jete i staxhionuar mire, pa nyje, te cara, vrima te vjetra gozhdash dhe gjera te ngjashme dhe pa material tjetër te huaj te ngjitur ne te.

5.17 Ndertimi dhe cilesia e armatures

Armatura duhet te jete mjaft rigjide dhe e forte ne menyre qe t'i qendroje forces se betonit dhe te cdo ngarkese konstruktive dhe duhet te jete e formes se kerkuar. Njeri nga te dy materialet mund te perdoret, druri ose metal. Cilido material te jete perdorur, duhet te jete i mberthyer ne menyre gjatesore dhe terthore, i perforcuar dhe gjithashtu per te siguroje rigjiditetin duhet te jete i papershkueshem nga uji ne te gjitha rastet e paparashikuara.

Armatura e mire duhet te perdoret per te prodhuar nje pune perfundimtare me cilesi te larte pavaresisht qe gjurmet e shenjave te kallepit te armimit mbi siperfaqen e betonit do te mbeten. Armatura duhet te jete nga veshje me derrase te thate, ose armature me siperfaqe metalike te cilesise se larte duhet te perdoren. Armatura e cilesise se ulet mund te perdoret per siperfaqe qe duhet te suvatohen ose ato te goposura ne toke, dhe duhet te montohen nga derrasa ne forme pykash me qoshet e lemuara dhe te sigurta ose nga armatura celiku te aprovuara.

Pjesa e brendshme e te gjithe armaturave (perjashto ato per punimet qe do te mbarohen me suvatim) duhet te lyhen me vaj liri, naftë bruto, ose sapun cdo here qe ato te fiksohen. Vaji duhet te aplikohet perpara se te jete vendosur perforcimi dhe nuk duhet lejuar qe lysterja te preke perforcimin. Vajosja etj, behen qe te parandaloje ngjitjen e betonit tek armatura .

Armatura duhet te goditet pa tronditur, vibruar ose demtuar betonin. Armatura qe do te riperdoret duhet te riparohet dhe pastrohet perpara se te rivendoset. Siperfaqet e brendshme te gjithe armaturave duhet te pastrohen komplet perpara vendosjes se betonit.

Kur armatura eshte prej lende drusore, siperfaqja e brendshme duhet te laget pikerisht perpara se te hidhet betoni per te shmangur keshtu absorbimin e lageshtires nga betoni.

Megjithate per ndonje armature momentale ose te propozuar duhet te merret miratimi i Mbikqyresit te Punimeve, dhe Sipermarresi duhet te mbaje pergjegjesi te plote per kapacitetin e tij dhe per permbushjen e kesaj klauzole si dhe per ndonje konsekuence te dukshme te nje pune te parakohshme ose te demshme.

Ai duhet te heqe dhe rivendose ndonje ngritje te manget ose derdhje te betonit per te cilen armatura ka defekte ne zbatim te kesaj klauzole, ne nje mase te tille sic ndoshta kerkoet nga Mbikqyresi i Punimeve.

Pasi te vendoset ne pozicion armatura duhet te mbrohet kundrejt te gjitha demtimeve dhe efekteve te motit dhe ndryshimeve te temperatures. Ne qofte se kjo eshte gjetur si e pazbatueshme per vendosjen e menjhereshme te betonit, armatura duhet te inspektohet perpara se betoni te hidhet per t'u siguruar qe bashkimet jane te puthitura, qe forma eshte sipas modelit dhe qe te gjitha papasterite jane rihequr perfshire ndonje veprim te ujit nga lageshtira e permundur me siper .

Vetem lidhjet dhe shtrengimet etj. te aprovuara nga Mbikqyresi i Punimeve duhet te perdoren. Terheqjet, konet, pajisjet larese ose te tjera mekanizma te cilat lene vrime ose depresione ne siperfaqen e betonit me diametra me te medha se 20 mm nuk do te lihen brenda formave.

5.18 Heqja e armatures

Armatura nuk duhet te levizet derisa betoni te arrije fortesine e duhur per te siguruar nje qendrueshmeri te struktures dhe per te mbajtur ngarkesen ne keputje dhe cdo ngarkese konstruktive qe mund te veproje ne te. Betoni duhet te jete mjaft i forte dhe te parandalohet demtimi i siperfaqeve nepermjet perdorjes me kujdes te veglave ne heqjen e formave.

Armatura duhet te hiqet vetem me lejen e Mbikqyresit te Punimeve dhe puna e dukshme pas marrjes te nje lejeje te tille duhet te kryhet nen supervizionin personal te nje tekniku ndertimi kompetent. Kujdes i madh duhet te ushtrohet gjate levizjes se armatures per te shmangur tronditjet ose ne te kundert shtypjen ne beton

Ne rastin kur Mbikqyresi i Punimeve e konsideron qe Sipermarresi duhet te vonoje heqjen e armatures ose per shkak te kohes ose per ndonje arsye tjeter ai mund te urdheroje Sipermarresin qe te vonoje te tilla levizje dhe Sipermarresi nuk duhet te ankoet per vonesa ne konseguence te kesaj.

Pavaresisht nga kjo ndonje njoftim i lejuar ose aprovim i dhene nga Mbikqyresi i Punimeve, Sipermarresi duhet te jete pergjegjes per ndonje demtim per punen dhe cdo demtim per rrjedhim shkaktuar nga levizja ose qe rezulton nga levizja e armatures.

Tabela meposhte eshte dhene si nje guide per Sipermarresin dhe nuk ka rruge qe cliron Sipermarresin nga detyrimet ketu:

Tipi i Armatures	Betoni
Soleta dhe traret ne ane te mureve kollonat e pangarkuara	1 Dite dhe
Mbeshtetjet e soleta dhe trareve qellimisht ne vend	7 Dite te lena
Levizja e qellimshme e mbeshtetseve Te soletave dhe trareve (temperatura e ambientit duhet te jete 25 grade celsius)	14 Dite

5.19 Betoni i parapergatitur

Perjashto rastin kur specifikohet ndryshe ketu njesite e betonit te parapergatitur duhet te derdhen ne tipin e aprovuar te cdo kallepi me nje numer individual ose shkronje per qellime identifikimi. Numri i shkronjes duhet te jete ose i stampuar ose e futur ne kallep ne menyre qe cdo njesi e betonuar ne nje kallep te posacem do te deshmoje identifikimin e kallepit. Ne vazhdim data e betonimit te produktit duhet gjithashtu te gervishtet ose lyhet me boje mbi modelin. Pozicioni i shenjës së identifikimit të kallepit dhe dates duhet të jenë në faqen e cila nuk do të ekspozohet në punën e perfunduar dhe duhet të aprovohet nga Mbikqyesi i Punimeve përpara se betonimi të fillojë.

Betoni për njesinë e parafabrikuar duhet të testohet siç specifikohet këtu dhe duhet të vendoset dhe kompaktohet nga menyrat e aprovuara nga Mbikqyesi i Punimeve. Njesitë e betonit të parafabrikuar nuk duhet të levizën ose transportohen nga vendi i betonimit derisa të ketë kaluar një periudhë prej 28 ditësh nga data e betonimit. Klauzolat këtu referuar betonit, hekurit të armuar dhe armatures duhet zbatuar njësoj edhe për betonin e parapergatitur.

5.20 Pllakat e betonit

- Për të mbrojtur betonin nga uji, karbonizimi dhe kripërat.
- Përdoret në SPA dhe hamame.

Karakteristikat dhe përfitimet:

- E lehtë në përgatitje dhe aplikim.
- Aplikohet me furçë ose me spërkatje.

- Rezistene ndaj presionit negativ dhe pozitiv të ujit (1 bar negative, 1.5 bar pozitive)
- E përshkueshme nga avujt e ujit.
- E papërshkueshme nga uji , veshje e pa-deformueshme nën efektin e pllakave të qeramikës me një performancë ngjitjeje të lartë dhe strukturë fleksibël.
- Qëndrueshmëri e lartë.
- MasterSeal 589 mbulon të çarat deri në 0.06mm kur aplikohet deri në 2mm trashësi dhe deri në 1.20mm kur përforcohet me rrjetë kundër ujit.
- E përshtatshme për trafikun këmbësor.
- Rezistencë të lartë ndaj joneve të dioksidit të karbonit. Nuk plasaritet.
- Rezistente në ciklin e ngrirje-shkrirje-ve.
- Ngjyra e bardhë ka rezistencë ndaj rrezeve UV (ultraviolet).
- Mund të përdoret e sigurt në serbatorë për ujë të pijshëm. (raporti i testit: *Chemical Analysis Laboratory, BS 6920 Standard Analysis Report*)

14.1.4 Riparues special me fibra polimere - MasterEmaco® N900 (ose ekuivalent me te)

Pershkrimi :

Llaç riprofilues final, thixotropic, me baze cementi, një komponentesh, i përbërë nga polimere të modifikuara dhe i përforcuar me fibra. Hidroizolues, kompesues në tkurje dhe me lidhje perfekte me nënbazën. Ideale si shtresë finale riparimi dhe suvatimi për trashësi nga: 1 mm – 5mm. Sipas EN 1504-3/R2.

Perdorimet:

- I përdoret për riparimin dhe si shtresë finale në sipërfaqen e betonit ose ato të realizuara me MasterEmaco S488.
- Realizon një shtresë të fortë dhe të papërshkueshme nga uji për sipërfaqe që do mbulohen me shtresë EP ose PU në objekte industriale.
- Realizon një shtresë të fortë për sipërfaqe të papërshkueshme nga uji.
- I përdoret për riparime në strukturat detare, tunele, parkinge n/tokesore, podrumet.
- I përdoret për riparime të defekteve të sipërfaqeve të betonit përpara se të përdoret lysterja me boje.
- Realizon një shtresë shumë të lemuar dhe të papërshkueshme nga uji nën shtresën e lyster me boje.
- Realizon një shtresë shumë të lemuar mbi sipërfaqen e suvase që do të riparohet.
- I përdoret si shtresë finale plotësisht e lemuar për riparimin e kolonave.
- Riparon defektet në betone.

Perfitimi :

- Perzihet vetem me uje dhe aplikohet lehtesisht.
- Ngjitje (lidhje) perfekte me nenbazen e betonit.
- Aplikohet ne siperfaqe shume te medha pa krijuar te çara.
- Thixotropic dhe mund te aplikohet shtrese mbi shtrese.
- I papershkueshem nga uji.
- Rezistent ndaj cikleve te ngrirje – bymimit.
- Kompeson tkurjet.

Paketimi : 25 kg thes.

Konsumi : ~ 1.7 kg /m² / per 1 mm trashesi

14.1.5 Shtrese finale mbrojtese me baze EP me rezistence shume te larte kimike - MasterProtect 180 (ose ekuivalent me te)

Përshkrimi i produktit:

MasterProtect 180, është një material veshës me dy pjesë me bazë rezine i zhvilluar veçanërisht për të mbrojtur betonin dhe çelikut. Përputhet me EN 1504-2.

Fushat e aplikimit :

- Aplikime vertikale dhe horizontale në interier dhe exterior.
- Çisterna metali ose betoni.
- Mure, si barrierë ndaj gazit dhe avullit, veshje rezistente ndaj materialeve kimike.
- Serbator vaji dhe nafte.
- Stacione energjitike, fabrika sheqeri, hangare dhe magazinim pijesh, zona me depozita të ujit të pijshëm.
- Rafineritë e naftës dhe fabrikat e letrave.
- Industritë e birrës ,verës dhe rrushit.
- Industritë e pijeve të lehta dhe të lëngjeve të frutave.
- Industrite e qumështit, djathit dhe kosit.
- Salcë domatesh dhe ushqim i konservuar në paketime metalike.
- Industritë e mishit dhe peshku.

- Industritë e mjekësisë, bojrave, letrave, baterive dhe fertilizuesve.
- Shtëpitë botuese, kuzhinat dhe ambientet e lavanderive.
- Laboratore spitalësh, menzat e ngrënies dhe ambiente me lageshti apo higjenike , përdoret vetëm për mure.

Karakteristikat dhe perfitimet :

- Ofron sipërfaqe me shkëlqim.
- Formon një strukturë që parandalon formimin e mikrobeve.
- E lehtë për tu pastruar dhe krijon ambiente higjenike.
- Rezistencë të lartë mekanike.
- Ka elasticitet në thithjen e lëvizjeve në sipërfaqet e metaleve.
- Ka fuqi më të larta kimike krahasuar me veshjet standarte epoksi.
- E lehtë për tu aplikuar me furçë, rul ose me metodë spërkatëse.
- I papërshkueshëm nga uji.
- Nuk përmban tretës.
- Mund të përdoret në çisternat me ujë të pijshëm. (ka nje raport testi: *E çertifikuar nga Hacettepe University Turkish Doping Control Center dhe Chemical Analysis Laboratory, BS 6920 Standard Analysis Report*)



DEA Studio
Drejtuesi Ligjor dhe Teknik
Urb. Ark. Ervin TAÇI



Elteknik

Rruga "Mujo Ulqinaku" P. Teknoprojekt Ap. 1/2
Tel/Fax: +355 42424810; Mob: +355 68
2023325 www.elteknik.al ; info@elteknik.al
Nipt Nr. J92117001D ; Kodi Fiskal: 3806967

PUNIMET ELEKTRIKE NE OBJEKTIN
RIKONSTRUKSION QENDRA
KOMUNITARE KULTURORE" DHIMITER
ORGOCKA "MALIQ

RELACIONI DHE SPECIFIKIMET
TEKNIKE PER PUNIMET
ELEKTRIKE

Fleta Kontrollit

Emri PROJEKTI ELEKTRIK
Projektit: RIKONSTRUKSION QENDRA KOMUNITARE
 KULTURORE " DHIMITER ORGOCKA "MALIQ

Pergatitur:



Elteknik

ELTEKNIK Sh.p.k
Rruga "Mujo Ulqinaku" P. Teknoprojekt Ap. 1/2
Tel/Fax: +355 42 269314/249741
Mob: +355 68 2023325
www.elteknik.al ; elteknik@elteknik.al

Pergatitur BASHKINE MALIQ
per: Korce, Shqiperi

Data: 08.03.2018

Realizoi: Ing. Armand Shkemi
 Ing. Alda Sokoli

Data	Revizion Nr.	Realizuar	Aprovoi	Realizuar nga	Firma
08.03.2018	0	A. Shkemi	A. Hafizi	ELTEKNIK	

Permbajtja



Te pergjithshme	4
1 Furnizimi me Energji Elektrike	
1.1 Furnizimi me Energji nga Rrjeti (OSHEE).....	4
1.2 Panelet Elektrik	4
1.3 Karakteristikat e paneleve.....	5
1.4 Automatet.....	5
1.5 Kushtet e Operimit	5
1.6 Matja e konsumit te energjise	6
2 Furnizimi me Energji Elektrike nga Gjeneratori.....	6
2.1 Furnizimi nga Gjeneratori.....	6
2.2 Paneli Gjeneratorit.....	6
2.3 Karakteristikat	7
3 Percjellesat dhe Kabllot	7
4 Tubat dhe kutite.....	8
4.0 Etiketimi	8
5 Ndricimi	8
5.1 Ndricimi brendshem	9
5.2 Ndricimi i korridorit	10
5.3 Ndricimi i zyrave dhe ambiente gjenerale.....	11
5.4 Ndricimi me Spote	12
5.5 Ndricimi Emergjences	13
5.6 Instalimet sipas Ambienteve	13
6 Sistemi i Mbrojtjes Atmosferike.....	14
7 Sistemi i Kontrollit te Kamerave (CCTV)	15
7.1 Konfigurimi i sistemit.....	15
8 Sistemi I Dedektimit kundra Zjarrit.....	16
8.1 Konfigurimi i sistemit.....	16
8.2 Paneli i kontrollit	17
8.3 Kompjuteri i Vizualizimit	17
9 Sistemi i Rrjetit Kompjuterik.....	18
9.1 Detaje te Instalimeve	18
10 Sistemi I Thirrjes se Personave me Aftesi te Kufizuara (Disable Unit)	19
11 Sistemi I Evakuimit	20
11.1 Stacion Thirrje me 6 Zona.....	20
11.2 Burimi i muzikes ne sfond	21
12 Ndricimi i Jashtem.....	21
12.1 Ndricimi i Fasades Ballore (Tipi 1).....	22
12.2 Ndricimi Fasades	24
12.3 Ndricimi gjelberimit, Kati 1, (Tipi 5)	



Te pergjithshme

Projekti elektrik parashikon furnizimin me energji elektrike te Qendres Komunitare Kulturore "Dhimiter Orgocka" ne Maliq te Korces.Godina permban Ambjente Zyrash , nje salle multifunksionale, nje salle teatri per femije dhe ambjente ndihmese. Llogaritjet e ngarkesave elektrike jane bere duke marre ne konsiderate fuqite e ndryshme te paisjeve elektrike te cilat jane parashikuar te montohen ne ambientet e qendres, si ndricimi, paisje elektrike, paisje per ngrohje dhe ftohje (rooftop dhe chiller), pompat e ujit sanitar etj.

Furnizimi me energji elektrike do te behet nga OSHEE nepermjet gabines elektrike me te afert apo nga pika e furnizimit qe do te percaktoje kjo kompani pas marjes se informacionit per fuqine e kerkuar dhe instaluar. Me qellim furnizimin me energji elektrike ne menyre sa me kostante te qendres eshte parashikuar dhe nje gjenerator I cili ne rast te mungeses se energjise elektrike nga rrjeti do te bej furnizimin me energji. Gjithashtu per sistemet e sigurise si CCTV, Alarmi I Zjarrit jane parashikuar qe te furnizohen me energji elektrike nepermjet UPS me qellim furnizimin me energji elektrike te panderprere.

Energjia elektrike ne gjithe ambientet e qendres do te realizohet nga panelet elektrik te cilet jane pozicionuar ne ambiente te posacme ne qendres te paraqitura ne "E-02_Planin e Fuqise dhe Data ". Paneli PE-01 I cili pozicionohet ne dhomen teknike, do te behet dhe zgjedhja e furnizimit me energji elektrike. Normalisht godina do te furnizohet me energji nga rrjeti i OSSHE. Ne munges te tij, gjeneratori do te vihet ne pune automatikisht dhe do te bej furnizimin me energji te godines.

Ngarkesa e cila do te furnizohet dhe me gjenerator do te jete 50-60% e ngarkeses totale. Ku eshte perjashtuar nga Gjeneratori pjesa mekanike e kondicionimit .Eshte llogaritur qe 50% e ndricimit te qendres te furnizohet me gjenerator nderkohe qe vetem nje pjese e paisjeve elektrike do te furnizohen me gjenerator.

1 Furnizimi me Energji Elektrike

1.1 Furnizimi me Energji nga Rrjeti (OSHEE)

Furnizimi me energji elektrike do te behet nga OSSHE me ane te kabines elektrike me te afert. Paneli Kryesore PE-01 do te pozicionohet ne katin podrum ne ambjentin teknik. Ne kete panel do te behet komutimi midis linjes se rrjetit dhe linjes se gjeneratorit. Ne te do te pozicionohet nje ATS (Automatic Transfer Switch) e cila do te realizoj kete komutim.

1.2 Panelet Elektrik

Panelet Elektrike jane pozicionuar ne dhomat teknike te godines.Paneli kryesore PE-01 eshte ne katin podrum ndersa paneli dytesore PE-02 ndodhet ne dhomen teknike ne Sallen multifunksionale. Paneli PE-03 eshte vendosur ne katin e pare ne ambjentet e teatrit te femijeve. Gjithahtu eshte menduar dhe nje panel PE-BAR per te krijuar mundesine e matjes se vecante per kete panel pasi mund te jepet me qera.Pozicionet dhe konfigurimi i paneleve do ti referohemi skemave te paneleve ne vizatim.



Skemat elektrike te paneleve jane ne vizatimet E-11. Keto panele do te furnizohen me nje kabell elektrik I cili do te percoj si linjen me rrjet dhe ate me gjenerator. Seksionimi midis rrjetit dhe gjeneratorit ne keto panel do te behet me ane te nje kontaktori I cili ne rast te mungeses se rrjetit do te bej stakimin e linjave te cilat ndodhen te lidhura pas tij. Nje kabell $2 \times 2.5 \text{mm}^2$ I cili do te vij nga paneli PE-01 I cili do te bej te mundur komandimin e ketij kontaktori i cili ne rast se rrjeti do te jet prezent atehere kontaktet do te jene te mbyllura. Ne rast te kundert do te behet stakimi I tij dhe kontaktet do te jene te hapura.

1.3 Karakteristikat e paneleve

Standarti i instalimit CEI EN 60439-1/IEC 61439 -1 -2

Forma dhe sistemi tokezimit: siç permendet ne diagramen principale (kryesore)

Me pajisje te dizenuara te treguar ne diagramat principale (kryesore)

Tensoni nominal: 400 V

Blindo Zbara : 3P+N

Shkalla e mbrojtjes - IP 65

Shkalla e mbrojtjes Mekanike – IK 09

Shkalla e Segregacionit – II

Nivel I rrymave te lidhjeve te shkurtra, $I_{sh}=20\text{kA}$

Pajisje matese dixhitale per vlerat e verteta per A, V, kW, kVAr, kVA, Hz, cos. phi

Pajisje per Mbrojtjen e mbingërkeses ne secilen faze

Automate kryesor me bobine ckycese ne rast alarmi nga transformatoret

Te lihen hapësire 30% ne kompozimin e paneleve.

Panele te jene modulare dhe te paisjet te kene strukture per fiksim modular

U_e = deri ne 1000V

U_i = Deri ne 1000V

Frekuenca = 50Hz

$U_{imp}=8\text{kV}$

1.4 Automatet

Standarti IEC 947-2

Vlerat e lidhjes se shkurter jene dhene ne vizatime

Cdo automat duhet te kete rrele elektrike dhe magnetike

Cdo automat duhet te kete kontakte me veshje argjendi

Ne baze te kerkesave te paraqitura ne vizatim automatet duhet te jene te motorrizuara.

Klasa e automateve jane te shenuara ne vizatime.

1.5 Kushtet e Operimit



Paneli i tensionit te ulet duhet te jete i montuar ne ambiente te brendeshe dhe te operoje ne vlera nominale per kushtet e ambientit dhe te mos japin asnje efekt negativ ose ndryshim.

Ambienti ku do te montohet ky panel duhet te plotesojne kushtet e meposhteme :

Temperatura Maksimale per kohe te shkurter : + 50°C

Temperatura mesatare maksimale per 24 ore : + 20°C

Temprature minimale : -5°C

Kushtet Atmosferike

Kondicionet nominale klimaterike : sipas standartiti (IEC 60439-1)

Lageshtia Relative : 85% ne 40°C

1.6 Matja e konsumit te energjise

Konsumi energjise matet ne hyrje te Panelit Kryesor, PE-01. Ne te do te montohet matesi I energjise elektrike I cili do te aprovohet nga operatoret e OSSHE.

2 Furnizimi me Energji Elektrike nga Gjeneratori

2.1 Furnizimi nga Gjeneratori

Per te siguruar furnizim te rregullt me energji elektrike te Qendres Komunitare Kulturore eshte parashikuar instalimi i nje gjeneratori qe do te mbuloje 30% ngarkesen elektrike te paisjeve te cilat do te instalohen ne objekt. Pozicionimi i gjeneratorit do te behet ne fazen e zbatimit duke marre me pare aprovimin e personave pergjegjes. Aktualisht pozicioni i menduar eshte prane HEAT POMP ne amjentet e jashteme. Fuqia e gjeneratorit eshte llogaritur te jete 60kVA dhe do te jete 80% I ngarkuar.

2.2 Paneli Gjeneratorit

- Ne rast te nderprerjes se energjise njesia duhet te filloje ne menyre automatike. Nese kemi mungese tensioni nga rrjeti, duhet te ndizet gjeneratori duke hapur automatet e rrjetit dhe seksionuesin, funksion te cilen do te bej ATS.
- Nepermjet njesive te kontrollit sistemi duhet te japi energji ne godine per me pak se 20 sekonda, duke i dhene ngarkese sistemeve
- Pas kthimit te energjise nga rrjeti, duhet te pakten te jete ne pune minimumi 30 sekonda,



perpara ndezjes se pajisjeve kryesore perseri. Duke patur parasysh qe per pajisjet e sigurise dhe ato te IT energjia e UPS eshte e mjaftueshme, kthimi ne rrjetin kryesor do te behet ne menyre te panderprere.

2.3 Karakteristikat

Gjenerator 100kVA
Furnizimi me Naftë
Standarti DIN/ ISO 8528-5
Koeficienti i fuqise $\cos\phi=0.8$
Aspirimi Ajer-Ajer i ftohur
Starti i Motorrit 24V / 7kW
Numuri i Poleve – 4
Izolacioni – Klasa H
Mbrojtja – Per instalim te Jashtem
Disbalanca totale e Harmonikave THD me e vogel se 2%
Automati 3 fazor, 200A, 10kA
Starti i motorrit ne 30%

3 Percjellesat dhe Kabllot

Percjellesat dhe Kabllot duhet te kene kerkesa te larta per tipin e izolimit, mbeshtjelljes, dhe percjellesve te specifikuar. Percjellesat dhe Kabllot te prodhuar 12 muaj perpara dates se levrimit te mallit nuk do te perdoren.

Kabllot e ushqimit te tensionit te ulet per sistemin e shperndarjes 450/700V duhet te jene konform me sistemet EN dhe TNC-S. Tipi izolimit duhet te jete rezistent ndaj lageshtires dhe nxehtesise, i pershtatshem per temperature pune maksimale deri ne 70 grade celcius. Kabllot duhet te jene nje cope pa lidhje mes tyre pervec rasteve kur distancat jane me te medha se gjatesia maksimale e kabllit.

Kthesat (perkuljet) e kablllove nuk duhet te jene me pak sesa ato te specifikuara nga prodhuesi per tipin e kabllit te specifikuar.

Te gjitha percjellesit duhet te jene prej bakri. Ato duhet te jene te plote siç kerkohen.

Seksionet minimale te percjellesve: te gjitha prizat: 2.5mm²/ instalimet e brendshme te ndriçimit 1.5mm², 450/700V, Kodi me ngjyra:

- Faze: E zeze, gri, kafe (kabllot)
- Faze: E zeze (telat)
- Neutri: Blu e lehte



- Tokezimi mbrojtës: Verdhe/jeshile (shirita)

Kabllimi Fuqise (AC)

Standartet

CEI 60 502 : Kabllo fuqie të izoluar dielektrike të plote për tensione nominale nga 1kV deri në 30kV..

CEI 60 227 : Përcjelles dhe kablllo të izoluar PVC për rryma nominale deri në 450/750V

Karakteristikat teknike

- I shtrire në kanalina me një shtresë për të gjithë kabllot që lartësohen.
- I etiketuar në secilën anë.
- Llogaritjet e seksionit të përcaktohen, duke patur parasysh ndoshta numrin e lartë të harmonikave.

4 Tubat dhe kutite

Instalimet e brendshme do të jenë të gjitha kabllot të shtrire në tuba fleksibel, në kanaline metalike dhe tuba fleksibel për instalimet brenda mureve. Instalimet elektrike do të realizohen nga tavani me kanalina metalike dhe degezimet e tyre do të jenë me kuti hermetike jashtë muri dhe tuba fleksibel të fiksuara në mur me anë të fashetave me grapeta. Shpërndarja kryesore e kablllove do të bëhet në kanalina metalike sipas

seksioneve të dhëna në projekt. Të gjitha ngjitjet vertikale të kablllove në puset elektrike do të realizohen me kanaline ladder të montuar në muret e tyre. Të gjithë kabllot duhet të fiksohen me kapse kablllosh dhe gjate fiksimi të tyre të tregohet kujdes ndaj prishjes apo demtimit të izolacionit të kabllit që mund të çojë në kontakt direkte të personave me rrymen elektrike.

4.0 Etiketimi

Të gjithë kabllot do të etiketohen sipas skemave të paneleve të shpërndarjes me numrin e qarqeve të tyre. Nëse kabllot ose tubat janë instaluar për një përdorim të mëvonshëm ose për të kursyer hapësirën kjo duhet treguar në etiketim. I njëjti informacion duhet të shënohet në të dyja anët e kablllove dhe kutive.


5 Ndricimi

5.1 Ndricimi brendshem

Ndricuesit ne te gjitha zyrat, ambientet me vende pune (PC) dhe sallat e mbledhjeve duhet te jene te mbrojtura nga pasqyrimi. Per ndrçimin ne ambientet e brendshme, mesatarja minimale e shkalles (grades) se ndrçimit Em dhe nga treguesi i ndrçimit Ra duhet te projektohet si me poshte bazuar ne standardin European EN 12464-1:

Te gjithë ndrçuesit do te jene te tipit LED. Per Zyrat do te perdoren ndrçues te tipit panel LED 35W ne forme katrore 60x60cm ose Spote inkalo LED rrethor sipas projektit te dhene te konfirmuar me Arkitektet. Per ambientet teknike, depot do te perdoren ndrçues gjatesore LED me dimensione 130x17 cm me mbrojtje IP 65. Per hollin Kryesor do te perdoren dy ndrçuese te varur me fuqi 2x80W te dimerueshem

Foto eshte demonstruese.




Ne Sallen multifunkionale do te kete dy lloje ndricimi.

Ndricimi skenik qe nuk eshte pjese e ketij studimi pasi eshte zhvilluar nga nje studio tjeter dhe ndricimi gjenera I salles.

Ky I fundit do te realizohet duke perdorur ndricues te tipir projector (ilustrimi ne foton me poshte) te vendosur ne shine te elektrifikuar si ne projekt. Gjithashtu Do te kete ndricim te fshehur LED sic tregohet ne detajet me poshte .


5.2 Ndricimi i koridorit



Tipi i Ndricuesit

Te dhenat teknike :

- Ndricues LED 35-50W
- Llamba 3000 lm, 3000K, CRI≥80
- Shkalla e mbrojtjes nga Pluhuri dhe Uji - IP 20
- Shkalla e mbrojtjes nga goditjet – IK 07
- Furnizimi me energji – 230V / 50Hz
- Montuar ne shine



5.3 Ndricimi i Zyrave dhe ambjente gjenerale



Te dhenat teknike :

- Ndricues LED 35W
- Llamba 4800 lm, 4000K, CRI≥80
- Shkalla e mbrojtjes nga Pluhuri dhe Uji - IP 20
- Shkalla e mbrojtjes nga goditjet – IK 06
- Furnizimi me energji – 230V / 50Hz (transformator i perfshire)
- Permasat 60x60x82 cm

5.4 Ndricimi me Spote




Te dhurat teknike :

- Ndricules LED 22W
- Llamba 2770 lm, 4000K, CRI≥80
- Shkalla e mbrojtjes nga Pluhuri dhe Uji - IP 20
- Shkalla e mbrojtjes nga goditjet – IK 07
- Furnizimi me energji – 230V / 50Hz (transformator i perfshire)
- Permasat $\Phi 24.5$ cm x 7.7cm

Fasada e Objektivit duke qene nje arkitekture e vjeter eshte mare ne konsiderate per ta nxjerr ne pah.

Eshte menduar nje ndricim me spote te jashteme per te ndricues pjese specifike te Fasades sic tregohet ne detajet me poshte.



Megjithate fjala e fundit do te jepet nga arkitektet edhe gjate fazes se zbatimit.



5.5 Ndriçimi Emergjences

Ndriçimi Emergjences Exit duhet te permbushe standartet dhe kerkesat e normave EN. Instalimi ndriçimit te emergjences duhet te instalohen ne te gjitha korridoret, ne rruget e shpëtimimit referuar vizatimit perkates.

Ndriçimi emergjences do te jete me ndricues me bateri vetjake. Baterite duhet te furnizojne ndriçuesit minimumi per tre ore. Per katin perdhe dhe me siper shkalla e mbrojtjes per ndriçuesit duhet te jete IP20, per ambientet teknike duhet te jete IP44.

Furnizimi me energji elektrike i ndricuesve do te behet nga paneli elektrik i katit korespondues sic paraqiten ne vizatimin e ndricimit emergjent

5.6 Instalimet sipas Ambienteve

Instalimet elektrike do te realizohen ne baze te standarteve dhe kerkesave ekonomike. Duke ju referuar linjave elektrike te paraqitura ne projektin elektrik seicila linje do te lidhet te paneli elektrik sipas emertimit. Nga paneli elektrik kabllot elektrik do te shkojne ne nivelin e tavanit nepermjet kanalines metalike ngjitese (leadder) e cila do te bej lidhjen me kanalinen metalike vertikale e cila do te kaloj ne koridorin e shkolles.

Instalimet elektrike ne ambientet e brendeshme do te realizohet me kabell bakri FROR me izolim PVC , ndersa per instalimet e jashteme do te behen me kabell FG7OR per instalime te jashteme.

Zyrat

Instalimet ne zyra do te behen duke marre ne konsiderate nje vend pune prane tavolines ku do te instalohen:

Dy priza shuko me furnizim nga linja e rrjetit

Dy priza me furnizim nga linja e gjenerator

Nje prize Data RJ45 FTP me kabell Cat. 6 FTP

Ky projekt ka mare ne konsiderate pjesen e linjave elektrike per kete kete objekt.



6 Sistemi i Mbrojtjes Atmosferike

Per kete ndertese do te instalohet nje sistem tokezimi sipas rregullave te shtetit shqiptar dhe standartit nderkombetar EN50174.

Sipas vizatimeve do te instalohet nje rrjet lidhje (MESH-BN), me elektroda tokezimi te vendosura ne distance nga njera-tjetra perqark godines. Ky sistem do te perfshije te gjitha lidhjet e tubave metalik dhe kablove ne nje terminal kryesor tokezimi. Kanalinat duhet te lidhen bashke me kontakte galvanike me sistemin e tokezimit ne panelet shperndares.

Rezistenca e rrjetit te tokezimit nuk duhet te jete me e madhe se 3 ohm. Te gjitha materialet e tokezimit duhet te jene hekur i zinkuar ne te ngröhte sipas shenimeve ne projekt.

Perpara dorezimti te punes nenkontraktori duhet te beje matjet e vlerave dhe te dorezoje procesverbal teknik me vlerat e matura. Matjet duhet te behen ne prezencen e personelit te qendres si dhe duhet te shoqerohet me foto te matjeve.



7 Sistemi i Kontrollit te Kamerave (CCTV)

7.1 Konfigurimi i sistemit

Sistemi CCTV perbehet nga kamera fikse te insaluara ne ambjentet e koridoreve dhe tek hyrjet/daljet e godines. Te gjitha kamerat do te lidhen me kabell Cat.6 FTP sipas vizatimit nga pajisjet kryesore te vendosura ne ambjentet teknike. Nepermjet Cat.6 do te mundesohet sinjali video dhe furnizime me energji PoE nga switch-et. Ne rastin kur gjatesia e kabllit do te jete me shume se 100m do te perdoret fiber optike me konvertues per sinjalin e videos dhe furnizim me energji nga UPS.

Sistemi permban:

- Kamera IP, fikse (DOME), me ngjyra, per instalim ne ambiente te brendshme
- Kamera IP, tipi BOX, per instalim ne ambiente te jashtme
- Patch panel per lidhjen e kamerave
- POE Switch per lidhjen e kamerave dhe furnizimin e tyre
- NVR per manaxhimin dhe regjistrimin e videove

Te gjitha paisjet e sistemit qe ndodhen ne rack do te furnizohen me energji te panderprere nga UPS. Pajisjet do te jene te pershtateshme per montim ne rack.

Video/Monitorimi do te lidhet me dhomen e sigurise.




Diagrama e sistemit te CCTV

8 Sistemi I Dedektimit kundra Zjarrit

8.1 Konfigurimi i sistemit

Ne ndertese do te instalohet nje sistem detektimi zjarri i adresueshem me pajisje sinjalizimi automatike si sirena me drite te integruar. Sistemi i zjarrit do te instalohet sipas teknologjise ring-bus. Te gjitha pajisjet e adresueshme jane te pajisura me izolator per te minimizuar zonat e pambuluara ne rast defektesh. Sistemi eshte instaluar sipas normave EN-54, DIN 14675 dhe ligjeve lokale.

Sistemi i Sinjalizimit te Zjarrit qe do te instalohet ofron mbulim te plote te te gjitha zonave ne objekt. Do te vendosen detektore tymi ne nivelin e poshtem dhe te siperm te tavanave te varur. Detektorët qe do te vendosen ne nivelin e siperm te tavanit te varur do te jene te pajisur me llampa sinjalizuese, te cilat do te vendosen ne nivelin e poshtem te tavanit per te sinjalizuar nese detektori i siperm ka detektuar tym. Do te vendosen pulsante me thyerje



per aktivizim alarmi ne te gjitha daljet kryesore. Sirenat do te vendosen ne te gjitha zonat ne menyre qe te sigurohet deggjimi i kerkuar. Sirenat do te jene te adresueshme dhe te konfiguruar sipas strategise Shkak-Pasoje. Transponderat e adresueshem do te vendosen ne loop-in e detektoreve per te mundesuar kontrollin dhe monitorimin e pajisjeve ndihmese p.sh :


- Ashensoret
- Ventilatoret
- Sistemi i Evakuimit

8.2 Paneli i kontrollit

Paneli i kontrollit do te jete i llojit modular me 2 loop-e. Paneli do te jete i llogaritur qe te permbaje edhe sistemin e sinjalizimit te magazinave ose me mundesi lidhje ne rrjet me panele te tjere nese do te vendosen. Paneli ka mundesi zgjerimi nese kerkohet ne te ardhmen. Paneli eshte dixhital, i adresueshem, me panel operimi me nderfaqe grafike te lehte per perdoruesin, dhe ka mundesi lidhje te detektorve, pulsanteve, sirenave apo moduleve I/O te adresueshem. Paneli i detektimit te zjarrit mund te programohet duke ofruar mundesi te medha fleksibiliteti.

8.3 Kompjuteri i Vizualizimit

Sistemi do te jete i menaxhueshem edhe nga kompjuteri i vizualizimit i pajisur me software-in. Kompjuteri i menaxhimit ben te mundur monitorimin dhe kontrollin e te gjitha godines nga nje vend i vetem. Paneli do te lidhet nepermjet rrjetit me kompjuterin e vizualizimit. Ky kompjuter do te ofrohet si pjese e sistemit te alarmit te zjarrit dhe do te jete i plote me te gjitha sistemet operative, programet dhe grafikene e kerkuar. Kompjuteri i vizualizimit do te kete nje grafike me ngjyra dhe te lehte per perdoruesin, joteknike dhe lehtesine e monitorimit te te gjitha funksioneve te panelit. Operatori do te kene mundesine per te shkuar ne zonen e deshiruar duke klikuar mbi ndonje prej tyre. Ai do te kete nje liste te te gjitha kateve qe kane sistem alarmi zjarri. Ai mund te zgjidhi katin e deshiruar dhe ne kete kohe duhet te shfaqet nje harte e katit me pozicionin ekzakt te te gjitha pajisjeve te alarmit te zjarrit. Ne harte tregohet edhe statusi i pajisjeve me ngjyra te ndryshme. Per shembull, e gjelber - gjendja normale, verdhe – gjendje mosfunktionimi dhe e kuqe – gjendje zjarri. Ne rast te ndonje ngjarje ne sistemin e alarmit te zjarrit, ne nderfaqjen grafike shfaqet ne harte vendndodhja e sakte e pajisjes qe ka shkatuar ngjarjen, arsyea si dhe hapat qe duhen marre.



9 Sistemi i Rrjetit Kompjuterik

9.1 Detaje te Instalimeve

Kabllimi i shërbimimeve IT duhet të vendoset sipas rregullave EN 50173 class Cat 6. Cdo kabell duhet të matet pas instalimit. Raporte të shkruara duhet të dorëzohen që tregojnë të gjitha rezultatet. Cdo vend pune (1 person) do të pajiset me një prizë data RJ45. Kabllimi do të bëhet me kabllo Cat.6 FTP. Linjat duhet të lidhen në të dy krahet, të gatshme për përdorim. Etiketimi duhet të bëhet në të dy krahet. Do të instalohet në rack dhe një patchpanel për hyrjen e sinjalit telefonik dhe shpërndarjen e tij nëpër vendet e punës. Gjithashtu është mundësia për të shpërndarë këto sinjale përmes kabllorëve data cat.6. Për çdo prizë në terren, duhet të ketë një prizë (post) në patchpanel.

Sistemi Kompjuterik në qendër do të jetë i përbërë nga dy Rack të cilët do të komunikojnë ndërmjet tyre me anë të fibërve optike MM me 8core.

Rack 01 do të montohet në katin përdehë tek ambienti i qendrës, dhe do të jetë rack kyresorë i godinës ku do të instalohen pajisjet e kompanive private të cilat bëjnë shpërndarjen e sistemit telefonik, internetin etj.

Rack 02 do të montohet në ambientin teknik të sallës së koncerteve dhe do të përdoret për nevojat e sallës si audio, mikrofonet etj




Diagrama e Sistemit Data

10 Sistemi I Thirrjes se Personave me Aftesi te Kufizuara (Disable Unit)

Ne godine eshte parashikuar nje tualet per personat me aftesi te kufizuar. Nje sistem thirrje me sinjalizim drite per personat me aftesi te kufizuar do te instalohet sipas rekomandimeve te prodhuesit. Sistemi duhet te jete ne perputhje me standartet DIN VDE 0834

Sistemi konsiston ne:

- Moduli i thirrjes me celes me tirante.
- Modul sinjalizimit montuar mbi deren e tualetit me ndicim alarmi te jashtem.
- Pulsant resetimi per te fikur alarmin brenda zones se tualetit
- Ushqyes per paisjet
- Modul sinjalizimi tek recepsioni

Kablrimi do te behet sipas instruksioneve te prodhuesit ndersa sistemi ne vetvete eshte i detyrueshem.

Thirrja e emergjeces aktivizohet nepermjet nje moduli thirrje me tirante qe eshte pershtatur per kete qellim dhe pozicionuar ne nje vend te dukshem ne mur jashte dhome nga llamba sinjalizuese e integruar e modulit elektronik. Si shtese, nje drite e kuqe ne tiranten do te sherbeje per te siguruar dhe sinjalizuar personin ne nevojë qe thirrja eshte derguar.



Pas kontrollit lokal mbi arsyen e aktivizimit te thirrjes, thirrja mund te resetohet duke shtypur butonin "reset".

Sistemi i thirrjes rikthehet ne kete menyre ne funksionim normal dhe gati per nje thirrje.

11 Sistemi I Evakuimit

Sistemi i evakuimit konsiston ne njoftimin zanor te nje mesazhi ne rast emergjence ne te ambiente te caktuara ose ne te gjithë godinen. Per kete sistem do te montohen autoparlante tavanor 6 W/100V, Autoparlatet duhet te lidhen nepermjet amplifikatorit te fuqise te pershtatshem me kontrolluesin e alarmit zanor dhe player-in e kombinuar DVD/CD.

Nje stacion thirrje me 6 zona duhet te instalohet ne dhomen e serverit.

Pajisjet kryesore te fuqise te sistemit te autoparlanteve sic jane amplifikatoret, kontrolluesi i alarmit zanor dhe player-i/tuner-i i kombinuar DVD/CD duhet te instalohet ne rack.

11.1 Stacion Thirrje me 6 Zona

Stacioni i thirrjes duhet te kete nje baze metalike per stabilitet, nje bosht mikrofoni fleksibel dhe nje mikrofon.

Duhet te jete pjese e nje sistemi amplifikimi zanor, ne menyre te tille qe te kete nje lidhje direkte midis stacionit te thirrjes dhe nje amplifikatori perkates. Stacioni i thirrjes duhet te kete nje kabell lidhje 5m me fund me nje lidhes DIN me 8 koka.

Stacioni i thirrjes duhet te mundesoje thirrjen deri ne kater zona te zgjedhura si dhe te kete nje buton te vecante per thirrjen e te gjithë zonave.

Duhet te jete e mundur per te vendosur etiketa te modifikueshme nga perdoruesi ne stacionin e thirrjes per te treguar emrat e zonave nga dritare transparente.

Stacioni i thirrjes duhet te kete nje filter zeri te zgjedhshem dhe nje limitues per degjueshmeri me te mire ne rast se folesi leviz para mikrofonit.

Autoparlatet jane projektuar per riprodhimin e fjaleve dhe muzikes, dhe perfshijne disa opsione speciale qe permiresojne cilesine e zerit. Keto perfshijne nje autoparlant me tre kone, nje porte reflektimi te bass-it, nje udhezues valesh opsional. Ndertimi me nje kornize rigjide zvogelon vibrimet e padeshiruara.



Njesite e autoparlanteve perfshijne shume opsione per te ndihmuar instalimin, duke perfshire nje celes per caktimin e fuqise, bloqet e terminalit me vida (per kabllime brenda loop), klema me vida dhe korda sigurie.

11.2 Burimi i muzikes ne sfond

Njesia duhet te perfshije nje player DVD/CD me nje ngarkues tek DVD/CD dhe nje tuner te kontrolluar ne menyre digitale per marrjen e FM dhe AM. Player-i DVD/CD duhet te jete i afte te luaje DVD/CD normale audio dhe video si dhe Mpeg2, CD MP3n ose CD-R DVD-rom, DVD-r me MP3 dhe shfaqes JPEG. Filet MP3 me bit-rates nga 32 kbps deri ne 320 kbps, mono/ stereo/joint-stereo, dhe duhet te suportojte bit-rates te vazhdueshme (CBR) dhe bit-rate variable (VBR). Njesia duhet te suportojte MP3-files te ruajtur ne nen-foldera me shume nivele per zgjedhje te lehte.

Gjithashtu sistemi duhet te kete te regjistruar nje regjistrim zanor ne shqip per sinjalizimin e evakuimit te godines ne rast emergjence. Ky sinjal mund te merret manualisht ose ne menyre automatike nga paneli i alarmit te zjarrit.


12 Ndricimi i Jashtem

Ndricimi i Jashtem ne Qendren Komunitare Kulturore ne Maliq do te realizohet referuar vizatimit te Ndricimit te jashtem. Komandimi i ndricimit te jashtem do te behet tek paneli PE-01 i cili ndodhet ne ambientin teknik. Komandimi i ndricimit te jashtem do te realizohet ne dy menyra :

- Ne menyre automatike
- Ne menyre manuale

Menyra automatike do te realizohet me ane te rrelese korpuskulare(muzgut) dhe relese se kohes.

12.1 Ndricimi i Fasades Ballore (Tipi 1)




Te dhenat teknike :

- Ndricules LED 20W
- Llamba 2300 lm, 4000K, CRI≥80
- Shkalla e mbrojtjes nga Pluhuri dhe Uji - IP 67
- Shkalla e mbrojtjes nga goditjet – IK 10
- Furnizimi me energji – 230V / 50Hz (transformator i perfshire)



Tipet e ndrcieseve te perdorur:



PROJEKTIM OBJEKTI PALLATI KULTURES
"DHIMITER ORGOCKA" MALIQ




Part number	304689
Lampholder:	LED
Light Source:	LED
Wattage:	OW
Finish:	WH-87/White/Textured
Insulationclass:	
Degree of protection:	IP65
IK-J-xxiP:	IK061J xx3
CRI:	80
Kelvin:	3000
Power factor:	COS<p 0,9
Optic:	SYMMETRIC EXTRA WIDE REFLECTOR
Lightsource lumen output:	1350 lm
Luminaire lumen output:	611 m
L:	L70
B:	B10
Lifetime:	35000 h



Part number	305171
Lampholder:	LED
Light Source:	LED
Wattage:	26W
Finish:	AN-96/Anthracitegray /Textured
Insulationclass:	
Degree of protection:	IP66
IK-J-xxiP:	IK0910J xx7
CRI: Kelvin:	70
Powerfactor:	3000
EEL:	COS<p 0,9
Optic:	A2
Optic Beam:	ASYMMETRIC WIDE REFLECTOR
Lightsource lumen output:	SS-
Luminaire lumen output:	2520 lm
L:	1857lm
B:	L70
Lifetime:	B10 60000 h




12.2 Ndricimi Fasades



Part number	305239
Lampholder:	LED
Light Source:	LED
Wattage:	SOW
Finish:	AN-961Anthracitegray / Textured
Insulation class:	
Degree of protection:	IP66
IK-J-xxIP:	IK0910Jxx7
CRI KeMin:	70
Power factor:	3000
EEl:	C05q> 0,9
Optic:	A2
Optic Beam:	ELLIPTICAL REFLECTOR
Lightsource lumen output:	15"x45"
Luminaire lumen output:	5040 lm
L: B:	3964lm
Lifetime:	L70 B10 60000 h



Part number	305334
Lampholder:	LED
LightSource:	LED
Wattage:	LED
Finish:	LED
Insulation class:	60W
Degree of protection:	GR-111 Anodised grey / Matt
IK-J-xxIP:	
CRI:	IP67
Kelvin:	IK1020Jxx9
Power factor:	80
Optic:	3000
Optic Beam:	COSq>0,9
Lightsource lumen output:	ELLIPTICAL REFLECTOR
Luminaire lumen output:	13"x36"
L:	5700 lm
B:	3991lm
lifetime:	L80 810 60000 h
Classificazione incassi:	
Temperatura vetro:	A1 A2 A3 A4 52°





PROJEKTIM OBJEKTI PALLATI I KULTURES
" DHIMITER ORGOCKA " MALIQ



Part number	06037904
Lampholder:	LED
Light Source:	LED
Wattage:	21 W
Finish:	INOX / Stainless steel / Matt
Insulation class:	I
Degree of protection:	IP 67
IK-J-xxIP:	IK10 21J xx9
CRI:	65
Kelvin:	6000
Power factor:	COS ϕ \geq 0,9
Optic:	ELLIPTICAL REFLECTOR
Optic Beam:	10°x50°
Lightsource lumen output:	1500 lm
Luminaire lumen output:	963 lm
L:	L80
B:	B10
Lifetime:	50000 h
Classificazione incassi:	A1 A2 A3 A4 A5
Temperatura vetro:	39°



Pergatiti per Elteknik sh.p.k
Ing.Armand Shkemi

**PROJEKT ZBATIMI
I SISTEMEVE TE INSTALIMEVE
MEKANIKE**

PROJEKT - ZBATIMI
“Teatri Maliq”

SHERBIMI I NXHINIERIK
RELACIONI PERFUNDIMTAR
I
PROJEKTIT

NORMA DHE PERCAKTIME TEKNIKE

Permbajtja

1.	TË PËRGJITHSHME	3
2.	SISTEMI I MBROJTJES NGA ZJARRI.....	7
2.1	Hyrje.....	7
2.2	Klasifikimi i zjarreve.....	7
2.3	Substancat shuarese te zjarrit	8
2.4	Pajisjet e shuarjes se zjarrit	8
2.5	Kritere te pergjithshme projektuese	8
2.6	Rezervuaret e ujit.....	9
2.7	Tubacionet e shperndarjes dhe lidhjet.....	9
2.8	Grupi i pompimit.....	10
2.9	Hidrant dhe fikset e zjarrit.....	11
3.	SISTEMI I FURNIZIMIT TE UJIT SANITAR (I FTOHTE / NGROHTE).....	11
3.1	Dimensionimi	11
3.2	Grupi i pompimit.....	11
3.3	Autoklava	12
3.4	Rezervuaret e ujit.....	12
3.5	Uji i ngrohte sanitar.....	12
3.6	Sistemi i shperndarjes.....	12
3.7	Valvolat	14
3.8	Pajisjet Hidrosanitare	15
3.8.1	WC dhe kaseta e shkarkimit	15
3.8.2	Lavamanet.....	16
3.8.3	Rubinetat.....	17
4.	SISTEMI I SHKARKIMIT TE UJRAVE TE ZEZA	18
4.1	Dimensionimi	18
4.2	Materialet e tubave	18
4.3	Rakorderit e tubave	19
4.4	Piletat.....	20
4.5	Pusetat e ujrave te zeza.....	20
4.6	Kullimi i ujrave te shiut.....	21
4.7	Pusetat e ujrave te shiut.....	21
5.	SISTEMI I AJRIT TE KONDICIONUAR.....	22
5.1	Kerkesa te pergjithshme	22
5.2	Konditat e jashteme te projektimit	22
5.3	Karakteristika arkitektonike	23
5.4	Humbjet e nxehtesise.....	23
5.5	Burimi i energjise	24
5.6	Pajisjet dhe makineritë kryesore.....	24
5.7	Sistemi i pompave per shperndarjes se ujit	27
5.8	Linjat e shperndarjes se ujit ne terminale.....	29
5.9	Sistemi i kanaleve te shpendarjes ajrit (ventilim / kondicionim)	33

1. TË PËRGJITHSHME

Kontraktori duhet qe me kujdesin e duhur dhe ne perputhje me dispozitat e kontrates te respektoje vizatimet e punimeve deri ne periudhen e percaktuar ne kontrate si dhe te kryeje perfundoje dhe te riparoje ndonje defekt te punimeve.

Kontraktori duhet te siguroje te gjithë personelin, materialet, impiantet, paisjet dhe te gjithë gjerat e tjera te nje natyre te perkohshme ose te perhershme qe kerkohen per vizatimin, kryerjen dhe perfundimin e punimeve si dhe per riparimin e ndonje defekti. Te gjitha sa u thane me lart do te jene te specifikuara ose nenkuptuara ne kontrate.

Te përgjithshme

Te gjitha materialet qe do te përdoren ne punime duhet te jene te reja, te modeleve me te fundit dhe te bëhen te gjitha përmirësimet e fundit te vizatimet dhe materialet, përveç se ne rastet kur kontrata parashikon dika tjetër.

Mjeshtëria e punimeve duhet te jete me e mira ne llojin e saj dhe e miratuar nga Inxhinieri.

Testimi i materialeve para përdorimit

Ndonjë ose te gjitha materialet e sjella nga Kontraktori për tu përdorur te punimet duhet ti nënshtrohet paraprakisht testeve qe specifikohen te standardi perkates, specifikimet ose sic shihet nganjehere e nevojshme nga Inxhinieri.

Kostoja e berjes se testeve tek materialet ose te mjeshteria e punimeve do te mbulohet nga cmimet e furnizimit te materialeve dhe sherbimeve perkatese.

Refuzimi

Materialet qe nuk i plotesojne kerkesat e specifikimeve do te refuzohen dhe furnitori do te njoftohet nga Inxhinieri.

Cilesia e Kontrollit

Kontraktori duhet te jete i pergjegjshem per cilesine e tij te kontrollit dhe duhet te kete nje staf te afte per te marre dhe pergatitur kampionet si dhe per te bere testet e nevojshme.

Lehtesirat e Testimit

Kontraktori duhet te identifikojë dhe te informojë me shkrim Inxhinierin per laboratorin ku mund te behen testimet per te siguruar qe cilesia e materialit dhe e punes po i permbahen specifikimeve te Materialeve.

Kostoja e berjes se testeve tek materialet ose te mjeshteria e punimeve do te mbulohet nga cmimet e furnizimit te materialeve dhe sherbimeve perkatese.

Paketimi

Te gjitha materialet duhet te paktohen ne nje menyre te atille qe te parandalohet demtimi ose prishja gjate transportit per ne destinacion. Paketimi duhet te jete i forte qe te duroje shkarkim te veshtire dhe ekspozim ndaj temperaturave ekstreme gjate tranzitit dhe magazimit. Cdo kuti ose arke amballazhi duhet te kete siper te shkruar ate cka ajo permban dhe emrin e adresen e prodhuesit, marresit si dhe daten e dergimit.

Transportimi i materialeve

Materialet e ndertimit duhet te mbahen dhe te transportohen sipas instruksioneve te prodhuesit.

Magazinimi i materialeve

Materialet e ndertimit do te ruhen ne vendet e miratuara nga Inxhinieri dhe ne cdo çast kontraktori duhet tu siguroje manaxhim te mire, mirembajtje dhe supervzim.

Furnizimi

Kontraktori mban përgjegjësi për furnizimin me materiale si dhe kryerjen e punimeve deri kur të miratohen përfundimisht nga Klienti ose Inxhinieri.

Programi i zbatimit

Brenda 30 ditësh pas fillimit të Kontrates, kontraktori duhet të përgatise dhe të dorëzojë për miratim nga ana e Supërvizorit një program zbatimi të kontrates. Programi duhet të përshijë një programim të detajuar të kohës duke patur parasysh nenkontraktoret e përshirë, kohën e inspektimeve dhe testeve specifike, një përshkrim të metodave që Kontraktori do të përdorë dhe një histogram të fuqisë punëtore.

*Dokumentacioni**Vizatimet në kantier të Prodhuesit*

Vizatimet të cilat dorëzohen nga Kontraktori për të dhënë një shpjegim të metejshëm për punimet e përhershme dhe që miratohen nga Inxhinieri do të jenë vizatimet e prodhuesit, por saktësia e këtyre vizatimeve do të jetë përgjegjësia e Kontraktorit.

Vizatimet në kantier "Draft"

Kontraktori duhet të përgatise vizatime paraprake dhe të dorëzojë tek Inxhinieri. Vizatimet në formë drafti duhet të dorëzohen Inxhinierit për miratim dhe pastaj të përfundohen sipas kërkesave ose përmirësimeve që behen. Kur të mbarojnë, kontraktori duhet të përgatise dy kopje të vizatimeve draft të pakten 14 ditë para se kontraktori të kërkojë një procesverbal dorëzimi për punimet përkatëse.

Vizatimet draft duhet të tregojnë rishikimet aktuale siç janë bërë në terren, duke përshirë të gjitha modifikimet që janë bërë gjatë ecurisë së punimeve.

Instrukcionet Manuale

Manualet e mirëmbajtjes të cilat japin të detajuar kërkesat e mirëmbajtjes për çdo detaj pune do të përgatiten nga Kontraktori dhe do të dorëzohen inxhinierit pas përfundimit të secilit sektor të punimeve si dhe dorëzimit të atij sektori. Manualet e mirëmbajtjes duhet të kenë formën e rene dakord me Inxhinierin. Duhet të behen 3 kopje në gjuhën Angleze dhe Shqipe për secilin sektor të përfunduar.

Siguria finale e cilesise dhe raporti i kontrollit

Raporti përfundimtar mbi cilësinë e punimeve të përfunduara duhet të përgatitet nga Kontraktori në fund të instalimeve duke u bazuar të raportet mujore, testet dhe inspektimet e bërë gjatë ndërtimit dhe punimeve përfundimtare.

Kontraktori duhet të paguajë të gjitha shpenzimet për përgatitjen e këtij raporti final, përveç se në rastet e përcaktuara ndryshe në Kontratë. Kontraktori bie dakord që as bërja e testeve dhe inspektimeve të Impiantëve dhe Paisjeve ose ndonjë pjesë tjetër e punimeve, as vëmendja e Pundhënesit ose Inxhinierit, as çështja e ndonjë rezultati testi nuk do të heqin Kontraktorit përgjegjësinë ndaj Kontrates.

Matjet

Në përfundim të punimeve, Kontraktori duhet që 14 ditë para dorëzimit për shfrytëzim të dorëzojë Inxhinierit raportin përfundimtar mbi cilësinë e punimeve. Koston për përgatitjen e raportit do ta paguajë Kontraktori.

Numri i punimeve individuale do të gjendet me anë të njësive matëse të përcaktuara të Programet/Preventivat, Dokumentat e Kontrates dhe Kërkesat.

Punimet do të llogariten në baze të vizatimeve, në rastet kur puna e përfunduar korespondon me vizatimet, nëse nuk përcaktohen ndryshe të Kushtet e Përgjithshme dhe të Vecanta ose të Standartet Shqiptare, metodën e DIN 18300.

Vetem kur nuk parashikohet ndryshe të Kërkesat, sasitë do të përcaktohen nga punimet e bërë ose sasitë e materialit të përdorur, duke patur parasysh që Inxhinieri nuk ka zgjedhur një mënyrë tjetër matëse.

Ndërkohe kontraktori duhet të kërkojë Inxhinierit të përgatise për dorëzim objektin sipas dispozitave të Kërkesave, në rastet kur është e pamundur të përcaktohet cilësia dhe sasia. Nëse Kontraktori nuk i plotëson

kerkesat e dorezimit, ai eshte i vetmi qe mban pergjegjesi per ndonje shpenzim shtese qe behet ne lidhje me punimet e nevojshme per perfundimin e kushteve aktuale.

Sasite e matura dhe dimensionet do te shkruhen tek Ditari i Punimeve. Te gjitha matjet do te perfshihen dhe te gjitha vizatimet e bera per pjeset qe do te mbuloen pas perfundimit ose per ato te bera ndyshe nga vizatimi. Kontaktori 1 here ne muaj duhet ti dorezoje Inxhinierit per miratim Ditarin e Punimeve, si rregull para se te behet raporti mujor.

Te dhenat e hedhura tek Ditari i Punimeve duhet konfirmohen nga te dyja palet kontraktuese ne menyre qe pranohet si baze per efekt page sipas raportit mujor.

Te gjitha kerkesat per page te bazuara tek te dhenat qe nuk kane miratimin e te dyja paleve kontraktuese mund te refuzohen nga Inxhinieri qe do te thote te perjashtuara nga raporti mujor.

Inxhinieri/ Perfaqesuesi i Klientit mund te refuzoje te miratoje/ konfirmoje te gjitha sasite e perdorura per punimet te cilat nuk jane bere ne perputhje me Kerkesat dhe Dokumentat e Vizatimit ne rastet kur Inxhinieri ka prova qe kerkesat nuk jane plotesuar.

Inxhinieri / Perfaqesuesi i Klientit mund gjithashtu te refuzoje te miratoje te gjitha sasine e perdorur per punimet e fshehura para se Inxhinieri te kontrolloje procedurat operative , dokumentat e materialit te future ne punime ose ne rastet kur Kontraktori ka vepruar ne menyre te atille qe mund te kercenoje zbatimin dhe sigurine e punimeve te perhershme.

Certifikatat dhe Pagesa

Punimet e kryera llogariten ne baze te raporteve te ndermjetem, mujore dhe perfundimtare ne perputhje me dispozitat e percaktuara te Kerkesat dhe Dokumentat e Kontrates.

Nese ka dyshime ne lidhje me cilesine e ndonje materiali ose pune, atehere Inxhinieri mund te pezulloje certifikimin gjate zhvillimit te testimi/ose inspektimi deri kur te tregohet qe materiali ose puna te perputhet me kerkesat.

Punimet shtese qe nuk perfshihen te Preventivat ne Kontrate do te llogariten mbi baza te Kushteve te Kontrates. Ne rastet kur dokumentat e Kontrates nuk permbajne dispozitat respektive, ateherepunimet shtese do te llogariten mbi baza te cmimit oer njesi per te cilin kane rene dakord te dyja palet gjate bisedimeve te kontrates. Inxhinieri duhet ti kerkoje Kontraktorit te jape nje ndryshim te detajuar te cmimit per njesi.

Te gjitha materialet e sjella per kryerjen e punimeve jane pasuri e Punedhensesit, I cili vendos se cfare duhet bere me keto furnizime.

Kampionet dhe Certifikatat e cilesise

Kontraktori duhet ti dorezoje Inxhinierit nje liste furnitoresh nga te cilet ai propozon te bleje materialet e nevojshme per kryerjen e punimeve. Nese kerkohet nga Inxhinieri, Kontraktori duhet te dorezoje vizatimet dhe specifikimet teknike dhe te dorezoje kampionet e materialeve te zyres se Inxhinierit.

Te gjitha materialet duhet te perputhen me Standartet e ISO dhe Furnitori duhet ti dorezoje Inxhinierit Certifikaten e Cilesise te permbushjeve te dhena nga prodhuesit te materialeve te cilat jane konform kerkesave te standarteve dhe se te gjitha teste e specifikuara deri ketu jane kryer dhe se jane plotesuar te gjitha kerkesat e testeve. Vetem ne rastet kur thuhet ndryshe, botimi I fundit I Standarteve te permendura do te perdoret.

Ne rastet kur nuk jepet ndonje specike e vecante per ndonje artikull ose material qe duhet te perdoret sipas kontrates, duhet te perdoren Standartet e duhura te ISO ose ekuivalenti i miratuar.

Kurdo qe kerkohen kampionet e Specifikimeve, Kontraktori duhet ti dorezoje per miratim Inxhinierit jo me pak se tre (3) kampione per cecilin material dhe pa kosto shtese ndaj Punedhensesit.

Te gjitha kampionet duhet te etiketohen individualisht, ku te tregohen karakteristikat specifike fizike dhe emrat e prodhuesve per identifikimin dhe dorezimin te Inxhinieri per miratim. Sapo te merret miratimi I Inxhinierit, nje set kampionesh do te vulozet dhe te vihet data nga Inxhinieri dhe ti kthehet Kontraktorit me ane te Perfaqesuesit Teknik per nje ruajtje te mire ne zyren e terrenit deri kur te mbarojne punimet.

Vetem ne rastet kur percaktohet ndyshe, te gjitha ngjyrat dhe fibrat te materialeve te percaktuar do ti zgjedhe Inxhinieri nga ngjyrat dhe linjat e prodhimit standarte te prodhuesit.

Testet e Perfundimit te Punimeve

Raporti perfundimtar mbi cilesine e punimeve te perfunduara duhet te behet nga Kontraktori ne fund te ndertimit duke u bazuar te raportet e ndermjetme, testeve ose inspektimeve te bera gjate perfundimit te punimeve te instalimit

Kontraktori duhet te paguaje te gjitha kostot dhe shpenzimet e bera ne lidhje me pergatitje e ketij raporti perfundimtar, pervec se ne rastet e percaktuar ndryshe nga Kontrata. Kontraktori bie dakord qe as berja e testeve ose inspektimeve te Impianteve dhe Paisjeve ose ndonje pjese tjeter e punimeve, as pjesmarrja e Punedhenesit ose Inxhinierit, as ceshtja e ndonje certificate testi do ti heqin Kontraktorit ndonje nga pergjegjesite qe ka sipas Kontrates.

Dorezimi per shfrytezim

Miratimi i perkohshem

Miratimi i perkohshem behet ne perfundim te ndertimit, qe do te thote ne perputhje me dispozitat e Dokumentave te Kontrates. Raporti perfundimtar qe Kontraktori I dorezon Inxhinierit/ Perfaqesuesit te Klientit bashke me dokumeta plotesuese sic pershkruhet te dokumentat e Kontrates, do te jene dokumentat ku do te bazohet Inxhinieri/ Perfaqesuesi i Klientit per te certifikuar pagesen dhe Punedhenesi ti paguaje shumen Kontraktorit, duke patur parasysh qe nuk ka ndonje diskutim ne lidhje me sasine ose cilesine e punimeve te bera.

Miratimi Perfundimtar

Miratimi Perfundimtar (qe ndryshe quhet Miratimi I Funkcionit) do te behet pas mbarimit te Periudhes se Pergjegjesise per Defektet. Do te krijohet nje komision per proceduren e Miratimit.

Pergjegjesia e defekteve

Vetem ne rastet kur percaktohet ndyshte nga kushtet e kontrates ose te specifikimet teknike periudha e pergjegjesise se defekteve eshte 2 vjet per punimet e instalimeve mekanike.

2. SISTEMI I MBROJTJES NGA ZJARRI

2.1 Hyrje

Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit eshte projektuar per te perballuar ne dy forma situatën emergjente per shuarjen e zjarrit.

Mbrojtja aktive :

Ka te beje me instalimin e dispozitivave shuares sikurse hidrantet e brendshem dhe te jashtem, fikset me shkume pluhur e gas, sprinklerat, detektoret tymit, flakes etj.

Mbrojtja pasive :

Ka te beje me materialet e strukturave te ndertesës, te cilat vleresohen ne baze te rezistences qe paraqisin karshi zjarrit, seksionet e ndarjeve, sistemin e daljeve te emergjences, ventilimit te tymrave etj.

Ne kete seksion do te trajtohet vetem pjesa aktive e sistemit te mbrojtjes kunder zjarrit bashk me pjesen e dedektimit dhe nderhyrjes automatike ne zona te caktuara.

Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit do te realizohet ne baze te:






Dimensioneve, specifikimeve dhe kualitetit te materialeve te percaktuar ne vizatim, instruksioneve te Inxhinierit perfaqses, standarteve dhe normave lokale si dhe ato te vendeve te Komunitetit Europian. Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit respekton te gjitha kerkesat e detyrueshme shteterore qe kane te bejne me normat / standartet qe jane ne fuqi aktualisht ne Shqiperi si dhe normat italiane CNVVF/CPAI UNI 9485. Gjate procesit te disenjmit dhe aplikimit te sistemit eshte mire qe te kontaktohet me autoritetet vendore te MKZSH per te siguruar nje testim dhe aprovim te ketij instalimi.

2.2 Klasifikimi i zjarreve

Per te perdorur agjente shuares te pershtatshem gjate procesit te mbrojtjes nga zjarri, ne funksion te materialeve qe mund te marrin flake, duhet te merren patjeter ne konsiderate klasa e zjarrit.

Ne baze te normave / standarteve bashkekohore, pajisjet shuares te zjarrit jane klasifikuar ne pese klasa.

Standardi europian DIN EN per keta shuarsa dallon klasat e meposhtme:

- | | | |
|-------|---|--|
| Klasa |  | Perdoret per zjarre qe e kane origjinen prej materialeve te ngurte sikurse derrase, leter, plastik, tekstile, etj. |
| Klasa |  | Perdoret per zjarre qe e kane origjinen prej materialeve telengshem sikurse benzene, benzole, nafte, alkol, vajra etj. |
| Klasa |  | Perdoret per zjarre qe e kane origjinen prej materialeve te gazte sikurse metan, propan, butan GPL etj. |
| Klasa |  | Perdoret per zjarre qe e kane origjinen prej materialeve metalike sikurse alumin, magnesium, sodium, etc. |
| Klasa |  | Perdoret per pajisje elektrike qe jane nen tension. |

Ne vizatime jane percaktuar me saktesi edhe zonat qe kane lidhje me klasat e zjarrit si dhe vendet ku jane vendosur hidrantet si dhe fikset e zjarrit.

2.3 Substancat shuarese te zjarrit

Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses si dhe aktivitetet qe zhvillohen, do te perdoren substanca shuarese si me poshte:

- Uje: (zyra, salla, ambiente te perbashketa etj.);
- Shkume: (salla e makinerive);
- Hidrokarbure pluhuri ose halogjene: (trasformator, UPS, panele elektrike) ;

2.4 Pajisjet e shuarjes se zjarrit

Tipet e fiksuar

- Hidrante ne brenedesi te godines (jane aplikuar)
- Hidrante jashte godines (jane aplikuar)
- Sisteme me shprinkler (nuk jane aplikuar)
- Shuares ne trajte hundeze (nozzle) (nuk jane aplikuar)

Tipe te levizshem (cilindra, karelato shkume, pluhur), (aplikohen).

2.5 Kriteria te pergjithshme projektuese

Eshte konceptuar qe te projektohet ne perputhje me kerkesat dhe normat e pajisjeve shuarse qe do te aplikohen. Duke konsideruar qe naspot zene pjesen me te madhe ne sistemin kunder zjarrit, ai analizohet ne menyre te vecante duke selektuar njekohesisht edhe tipologjine tij.

Efikasiteti i sistemit te mbrojtjes kunder zjarrit pa anashkaluar aftesine e operatoreve, do te varet ne nje shkalle te larte nga mjaftueshmeria e kapacitetit te ujit dhe presionit te tij, te cilet duhet te jene te mjaftueshem per te shperndare ne lançe sasine e nevojshme te ujit si dhe te kene mundesine e kontrollit dhe te shuarjes ne kohen e duhur nje zjarr te mundshem.

Faktoret percaktues

Faktoret percaktues qe duhen marre ne konsiderate gjate projektimit duhet te jene :

- ▶ Natyra dhe permasa e zjarrit;
- ▶ Madhesia e zones qe do te mbrohet;
- ▶ Mundesia e perhapjes me shpejtesi e zjarrit;
- ▶ Kerkesat dhe normat sipas UNI 10779, NFPA 2001 si dhe ato qe jane ne fuqi ne Shqiperi.

Furnizimi me uje i sistemit te mbrojtjes nga zjarri

Pajisjet e shuarjes se zjarrit duhet te disponojne sasine complete te ujit te nevojshem per luftuar zjarrin ne momentin kur ai shfaqet. Kjo do te realizohet nepermjet instalimit te naspove te ujit brenda nderteses. Këto nga ana e tyre duhet te furnizohen me sasinë e duhur te ujit si dhe presionin e mjaftueshëm .

Burimi i furnizimit me uje

Furnizimi me uje konsiston ne nje nga kombinimet e meposhtem:

- ▶ Lidhja me rrjetin e ujit te qytetit;
- ▶ Rezervuari i nendheshme beton/arme i lidhur me nje pompe me seksion te pershtatshem per furnizim.

Sasia e ujit te kerkuar:

Kerkesat per depozitim te ujit per mbrojtje kunder zjarrit jane bazuar ne konsiderimin qe ne nje kohe te mundshme mund te perballemi me rrezikun e çfaqjes se zjarrit. Sasia e ujit qe kerkohet eshte barabarte me kerkesat per uje te vazhdueshem per shuarjen e zjarrit si dhe kohën ne dispozicion qe duhet per eliminimin e tij. Kjo sasi perzanton realisht depoziten e nevojshem ne dispozicion per mbrojtjen nga zjarri.

Ne rastin tone konkret ku jane marre ne konsiderate aktivitetet qe kryen ne godine, lendet dhe materialet e depozituar, referenca i perket zonave me ngarkese zjarri te moderuar. Ne kete rast sistemi duhet te posedoje karakteristika te tilla:

Pra duhet garantuar nje sasi uji qe te furnizojë hidrantet qe ndodhen ne nje pozicion hidraulik me te sfavorizuar me sasi uji minimale prej 120 l/min per rastin e nje kolone vertikale dhe me dy ose me shume kolona duhen te furnizoj minimalisht 3 hidrant per kolone ,me presion ne dalje prej 1.5 bar dhe nje kohe zgjatje prej 60 min.

▶	<i>Presioni</i>	min / max: 2 / 4.5 (bazuar ne formulën Hazen Williams, presion 15 m, humbje 10 m, presion pune 15 m)
▶	<i>Zona e mbrojtur</i>	≤ 1000 m ²
▶	<i>Autonomia</i>	≥ 60 min

2.6 Rezervuaret e ujit

Depozitat e ujit do te jete ne formen e rezervuareve te nendheshem beton arme dhe qe duhet te jene ne perputhje me dimensionet dhe percaktimet te bera ne vizatim, duke perfshire lidhjet, menyren e furnizimit me uje, tubacionet lidhese, kaperderdhjen, galexhantet elektrik, elektrovavola nderprerese etj, si dhe te gjitha kerkesat per te siguruar nje funksionim normal.

Rezervuaret e mesiperm duhet te sigurojne sasine e nevojshem te ujit sipas percaktimeve te mesiperm. Volumi i tyre si dhe specifikimet teknike te tjera jane prezantuar ne vizatimet perkatese.

Volumi dhe sasia e rezervuarve duhet kalkuar edhe ne vartesi te kerkesave speciale per mbrojtjen kunder zjarrit, sikurse numri i hyrjeve ne ambiente te veçanta, siperfaqeve qe mbrohen, normave specifike etj.

Materiali i rezervuarve duhet te jete prej beton arme me nje veshje finale antibakteriale. Forma e tyre do te jene sipas projektit. Kjo forme varet nga vendi i instalimit dhe kerkesave ne projekt.

Rezervuaret e ujit do te ndertohet ne pjese te percaktuara rigorozisht ne projekt.

Te gjitha punimet e instalimit duhet te kryhen ne menyre perfekte dhe ne perputhje me kerkesat teknike qe kerkohen ne projekt.

2.7 Tubacionet e shperndarjes dhe lidhjet

Diametrat dhe gjatesite e tubove sikurse e theksuam me siper do te jene ne vartesi te volumit te ujit dhe te gjitha lidhjet e rrjetit te brendshem te furnizimit me uje do te kalkulohen me te njejten metodologji sikurse ato te furnizimit me uje sanitar.

I gjithë rrjeti i brendshem do te pergatitet prej tubo çeliku pa tegel dhe me mure te trashe. Tubot me filetim duhet te shmangen. Lidhjet prej çeliku pa saldim si dhe ato prej materialesh te tjere jo te djegshem mund te perdoren.

Kontraktori duhet ti vere ne dispozicion Inxhinierit te zbatimit te gjitha vizatimet e punes ne te cilat tregohet lay –out i tubove ne te gjithë ndertesën si dhe aksonometrine e tyre.

Keto lay –out e duhet te tregojne te gjitha kuotat, gradientet, kthesat etj. Projektuesi ne kete rast duhet te marre parasysh qe te projektoje rrjetin e tubacioneve me nje minimum te numrit te perkuljeve dhe te kthesave te detyrueshme, por njekohesisht duhet te parashikojte te pakten nje perkulje per zgjerimet dhe kontraktimet termike. Rrezja minimale e kthesave te tubove duhet te jete sa trefishi i diametrit te tubit. Tubot duhet te jene ankoruar dhe te siguruar per te minimizuar demtimet dhe vibrimet . Suportet duhet te sigurojne gjithashtu nje ekspansion termik normal te tubove.

Te gjitha tubacionet do te mbulohen mbas perfundimit te te gjitha punimeve te muraturave. Tubot duhet te jene lidhur dhe te vendosur ne mbeshtjellje kur duhet te jete e nevojshme. Tubot asnjehere nuk do te mbulohen pa miratimin e inxhinierit supervisor. Ne te gjitha rastet duhet te parshikohet mbrojtja nga korozioni.

Mbas perfundimit te punimeve te instalimit te tubacioneve ata duhet ti nenshtrohen proves ne nje presion 8 here me te madh se ai i punes per nje kohe prej 4 oresh. Çdo rrjedhje e konstatuar do te riparohet duke perseritur testimin e mesiper perseri.

Te gjitha tubacionet brendshme duhet te kene seksion te brendshem rrethor dhe nje spesor uniform si dhe te gjitha siperfaqet e brendshme dhe te jashtme duhet te jene pa defekte dhe gërvishtje.

2.8 Grupi i pompimit

Pompa e zjarrit duhet te jene te asbluara ne nje stacion te vetem pompimi dhe duhet te jene kompozuar ne perputhje me kerkesat e projektit.

Ky grup pompe konsiston nga dy pompa zjarri shërbimi njera me motor disel dhe nje me motor elektri dhe nje pomop prove (Joky Pump) elektrike, e kompletuar me panelit te komandimit si dhe aksesoreve te tyre. Konstruksioni i pompave do te jete vertikal ne te cilat presioni realizohet konstruktivisht me aksion centrifugal.

Stacioni i pompimit eshte i pajisur me panel kontrolli i cili komandon secilen pompe dhe ku pajisjet e tyre komandojne ne menyra te percaktura, sikurse nisjen, ndalimin e pompes duke realizuar njekohesisht monitorimin dhe sinjalizimet e nevojshem duke percaktuar keshtu statusin dhe kondicionet e stacionit te pompimit .

Perpara daljes nga fabrika çdo pompe duhet te testohet hidraulikisht nga kjo fabrike per nje periudhe te pakten prej 5 minutash. Testi i presimit nuk do te kryhet me me pak se 16 bar. Gjate presimit nuk duhet te kete shfaqje te rrjedhjeve si dhe nje kopje e testit duhet te shoqeroje grupin gjate levrimit .

Burimi i ujit qe duhet te kene pompa dhe rrjeti ne dispozicion duhet te jete i pershtatshem ne ne kualitet dhe ne sasi . Keto karakteristika duhet te percaktohen para perzgjedhjes se pompave mbasi ato parashikojne te dhenat teknike te lejshme per kualitetin ujin qe pompojne. Gjate kalkulimit te prevalences se pompes (presioni i kerkuar) duhet marre ne konsiderate lartesia e nderteses, presioni ne dalje te hidrantit me te fafavorizuar si dhe humbjet lokale gjatesore dhe ato lokale.

Secila pompe duhet te jete e pajisur me valvol sigurie si dhe nje valvol mbyltese nese kemi mungese te presionit ne thithje te saj. Kjo valvol vendoset ne seksionin e dergimit perpara valvoles se kontrollit ne dergim. Ajo eshte valvol parandaluese ne rastet e mungeses se ujit ne rrjet per te parandaluar keshtu mbinxehjen e pomapve gjate punes ne boshllek. Parashikime duhet te behen edhe per shkarkimin e ujit ne pusete. Minimumi e dimensionim te valvolave te shkarkimit do te jete 3/4”.

Pompa e zjarrit, motorat elektrike si dhe paneli i kontrollit duhet te jene te mbrojtur kunder nderprerjes se sherbimit ne raste kur ka eksplozione, zjarre, termete, stuhi, ngrirje, vandalizma si dhe raste te tjera te ngjashme. Kujdes duhet bere edhe per ventilimin e dhomave te pompave.

Pompa e zjarrit duhet te instalohen ne pjese te veçanta te ndertesës te cilat duhet te jene te pershtatshme per mirembajtje dhe sherbime te rastit. Ne varesi te skemes se perzgjedhur ato mund te instalohen ne bazamentin e ndertesës.

Perceç kesaj ato duhet te vendosen dhe te mberthehen ne suporte metalike te cilet jane te mberthyer ne bazamentin e ndertesës. Keto suporte metalike nuk duhet te jene te lidhur me muret apo themelet e ndertesës. Pompa lidhen me rondele gome, si dhe jasteke rere ose druri apo binare druri per te eliminuar zhurmat gjate punes.

2.9 Hidrant dhe fikset e zjarrit

Shuaresit e zjarrit mund te klasikohen si me poshte:

- ▶ Hidrant ne brendesi te godines;
- ▶ Fikse te levizshme;
- ▶ Cilindra fiks te ndryshem.

Shuaresit e zjarrit me uje jane perzgjedhur si komponentet me aktive ne sistemin e perzgjedhur te shuarjes se zjarrit. Ata jane llogaritur te kene ne dispozicion te tere sasine e ujit te nevojshem ne rastin e çfaqjes se zjarrit. Kjo eshte bere e mundur me parashikimin ne projekt te instalimit te hidranteve ne brendësi te godines.

Ne menyre qe hidrantet te kene sasine e nevojshme te ujit si dhe nje presion te mjaftueshem projekti eshte pergatitur ne perputhje me normat qe dimensionojne llojin e hidrantit qe duhet te instalohen ne objekt. Ata jane instaluar ne çdo kat ne afersi lances rreziku potencial te zjarrit si dhe jane vendosur ne kuti çeliku te emaluar dhe te lyer me boje te kuqe si dhe me xham ne faqen e perparme.

Hidrantet jane te perbere prej saraqineskes nderprerese, tubit te gomuar per kalimim e ujit me nje gjatesi prej 30 m, lançes si dhe sprucatorit. Te gjitha keto pajisje jane te vendosura ne boksine prej llamarine çeliku, i cili vendoset ne brendesi te murit dhe ka nje nivel me siperfaqen e tij.

3. SISTEMI I FURNIZIMIT TE UJIT SANITAR (I FTOHTE / NGROHTE)

3.1 Dimensionimi

3.2 Grupi i pompimit

Grupi i pompimit te ujit eshte pjesa me rendesishme e sistemit. Ai eshte parashikuar te funksionojë me pompa dhe rezervuar beton arme parametrat e te cileve jane llogaritur ne perputhje me diagramat ditore te nevojave per uje dhe konfiguracionit te rrjetit.

Ne funksion te tyre jane llogaritur presioni, prurja, fuqite e pompave si dhe specifitime teknike te tjera te paraqitura ne vizatim. Sistemi eshte projektuar duke parashikuar nje stacione pompimi, i cilat duhet te instalohen ne perputhje me kerkesat e projektit.

Stacioni automatik i furnizimit me uje sanitar

Stacioni eshte parashikuar qe te sigurojë nje sasi uji qe perafersisht te mbulojë 48 ore autonomi dhe qe do te depozitohet ne rezervuarin beton arme te llogaritur per kete qellim.

Stacioni eshte parashikuar qe te furnizojë vetem me uje te ftohte sanitar te gjitha pajisjet h/sanitare qe jane instaluar ne kete objekt. Pajisjet e ketij stacioni jane instaluar ne ambientet e percaktuar ne projekt dhe jane te pershtatshme per shfrytezim, sherbime, kane ventilim te mjaftueshem dhe mungese lageshtire. Sipa skemes se zgjedhur ata duhet te vendosen ne bazamentin e soletes se ndertesës.

Ky stacion eshte kompozuar nga dy pompa uji ne versionin e pompave centrifugale me shume shkalle vertikale. Keto pompa jane vendosur ne nje bazament me konstruksion llamarine çeliku te galvanizuar e

mbeshtetur ne suporte çeliku me gome antivibrante per te eliminuar vibrimet dhe zhurmat gjate pune se pompave. Suportet metalike nuk jane te lidhura me bazamentin ose muret e ndertesës.

Pompat jane pajisur me kolektoret e thithjes dhe dergimit qe jane te galvanizuar me veshje shtrese epoxidi. Ato kane ne perberje gjithashtu flusometer, manometer, valvola nderprerse, moskthimi si dhe panel elektrik komandimi dhe kontrollolli, si dhe presostate te taruar paraprakisht.

3.3 Autoklava

Autoklave është një paisje e cila montohet prane pompes se ujit sanitarë, e cila shërben për të rritur presionin e ujit në ndërtesa.

Presioni i ujit mund të ndryshojnë gjatë gjithë ditës në bazë të konsumit, praninë e ndonjë rrjedhje në tubacioneve dhe presion në pikën e erogacionit. Në përgjithësi, presioni i ujit është një bar pak. Një bar (1 km/cm²) mund të ushtrojë presion të mjaftueshme për të ngritur ujin në një lartësi kolonë prej rreth 10 metra. Rrjedha e ujit mund të jetë e pamjaftueshme dhe e paqëndrueshme në vendet e larta, në raste të tilla është e nevojshme për të përdorur një autoclave.

Autoklave është një enë nën presion, ku pompa e karikon atë në baze të takim stakimeve për të marrë një presion më të madh se ai i rrjetit të ujit. Pasi arrihet presioni i dëshiruar, pompa fiket dhe sistemin e mban të karikuar vetë autoclava.

Materiali i autoclaves është pre çeliku me karbon , i mbrojtur me një shtrese epoxidi në ngjyrë blu blu RAL 5015, e polimerizuar.

3.4 Rezervuarët e ujit

Rezervuarët e ujit janë të kalkuluar dhe dimensionuar që të sigurojnë një presion dhe sasi uji në qendër për një autonomi të kërkuar prej 48 orësh. Specifikimet (presioni, sasia, kapaciteti etj.) janë përcaktuar nga projektuesi në baze të diagrames së shfrytëzimit ditor nga konsumatorët.

Volumi i rezervuarit të ujit do të kalkulohet në varesi të skemës së projektit dhe autonomisë. Depozita e ujit duhet të jetë me llamarinë të zinkuar, dhe forma e tyre do të jetë rrethore, vendosje vertikale në varesi të vendit ku do të montohen dhe kërkesave të projektit. Trashësia e materialit të llamarinës llogaritet në varesi të volumit të rezervuarit dhe formës së tij por gjithmone duhet të jetë jo më pak se 1 mm.

Depozitat e ujit duhet të vendosen nëntokë dhe në zonën sic tregohet në projekt.

Te gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e depozitës së ujit, duhet të behen dhe sipas kërkesave teknike të supervizorit dhe të projektit, do t'i jepet për shqyrtim supervizorit për një aprovim para se të vendoset në objekt.

3.5 Uji i ngrohte sanitar

Uji i ngrohte sanitar është menduar të realizohet prej prodhuesit të energjisë solare që në rastin tonë do të jetë me prodhuar nga kompozimi i pasqyrave termike solare, nga një akumulator dhe njëje të tjera lidhese në përdorim duke nderlidhur tubat dhe sistemin e lengut për të levizur nxehtësinë nga pasqyra në akumulatorin e nxehtësise.

3.6 Sistemi i shpërndarjes

Sistemi i ujit të ngrohte sanitar do të shërbejë për të siguruar ujin e ftohtë dhe të ngrohte nga stacioni i pompimit tek kolektoret dhe mbas kësaj të sigurojë shpërndarjen e ujit në pajisjet e ambienteve sanitare. Sistemi i tubave të ujit sanitar do të plotësojë kërkesat e normave dhe standarteve të përcaktuara dhe

seleksionuar qysh ne fazen e projektimit prej stafit inxhinierik si dhe te kerkesave paraprake te investitorit. Tubo e ketij sistemi jane ndare ne funksion te materialit te tyre si me poshte:

- Tubo çeliku te zinkuar pa tegel
- Tubo PE-Xa – (Polyetilen i retuikular)
- Tubo PEHD – (Polyetilen i densitetit te larte)

- Tubot e çeliku te zinkuar pa tegel do te perdoren ne furnizimin e ujit nga pompat, rezervuaret si dhe ambientet e salles se makinerise.

- Tubat plastike (PE-Xa) jane rezistent kunder korozionit. Ata duhet te vendosen ne vende, ku materialet e lartpermendura nuk mund te vendosen per shkak te korozionit dhe agresivitetit te ujit. Ne rastin konkret at jane perdorur ne dyshemene e te gjithë ambienteve. Duhet kujdesur qe tubat plastike, te plotesojne kerkesat e shtypjes dhe temperatures se nevojshme.

Tubo Polyetileni (PE-X) te perkulshem jane perzgjedhur ne perputtje me standarte internacionale te kualitetit ISO 9001 or DIN 53457. Keto tubo jane vendosur ne dyshemete e ambienteve dhe kane veti te shkelqyera si dhe karshi agjenteve kimike, stabilitet te larte termik, peshe te ulet, humbje te ulta presioni, te thjeshte ne mirembajtje per riparime dhe transport, te thjeshte ne instalim dhe nje jetegjatesi prej mbi 50 vjet .

Vetite termofizike te tubove PE-Xa jane me poshte si vijon:

- Densiteti 0,93 g /cm³
- Temperatura deri ne 110 °C
- Percjellshmeria termike 23 W/mK
- Koeficienti i zgjerimit termik linear 1,4 x 0,0001 K -1
- Moduli i elasticitetit ne 20 grade 670 N/mm²
- Ashpersia e tubit 0.007 mm


- Tubo PEHD (Polyetilen i densitetit te larte) HD5620EA eshte nje tub me densitet te larte molekular te shpendarjes se perhapjes ne cdo centimeter te gjatesise se tubit. Keto shkalle te densitetit te tubovae kane karkarakteristikat e meposhteme:

- Fleksibilitet per sasi te madhe fluidi;
- Faqe me rezistenc te madhe;
- Fleksibel per perdorim te shpejte.

Specifikimet:

Karakteristikat	Njesi	Vlera	Metodat e testimit
MFI (190°C/2.16 kg)	gr/10 min	20	ASTM D 1238 –7 konditat E
Densiteti	gr/cm ³	0.956	ASTM D 2839 - 69
Tensionet e fortesise ne rrjellje	Mpa	22	ASTM D 638 - 72
Tensionet ne zëratim dhe thverie	%	900	ISO R527-Tipi 2 shneitesia D
Tensionet ne perkulje	Mpa	1000	ASTM D 790 - 71
Impakti i fortesise ne fortesi	KJ/m ²	10	ASTM D 256 - 73B
Fortesia	Shore D	66	ASTM D 2240 - 75

Menyra e shtrirjes se tubave, kuotat, shtresat e ndryshme per mbeshtetjen dhe mbulimin e tubacioneve jane dhene ne detajet teknike e projektit.



Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tubacioneve te ujit ne objekt, duhet te behen dhe sipas kerkesave teknike te supervisorit dhe te projektit. Nje katalog me te dhenat teknike , çertifikatat e cilesise, origjines se materialit, garancia minimale prej 3 vjetesh dhe çertifikata e testimi te bere nga prodhuesi, do t'i jepet per shqyrtim supervisorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt.

3.7 Valvolat

Valvolat jane pajisje te veçanta qe do te perdoren per kontrollin e rrjedhjes ne tubacionet e ujit. Me ane te saraçineskave mund te ndryshohet madhesia e prurjes qe i jepet pjeses tjetere te tubit ose nderprerjen e plote te rrjedhjes. Valvolat mund te jene me material bronxi, gize ose çelik inoksi. Ato jane te tipit me sferë ose me porte, me bashkim, me filetim ose me fllanxa. Valvolat sipas menyres se bashkimit me tubat i ndajme ne lloje: me fllanxe dhe me fileto.

Valvolat qe perdoren ne nje linje ujesjellesi duhet te perballojne nje presion 1,5 here me teper se presioni i punes. Ato duhet te perballojne nje presion minimal prej 10 bar.

Valvolat duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshte riparimi dhe transporti, jetegjatesi mbi 25 vjeçare dhe qendrueshmeri ndaj goditjeve mekanike.

Ne raste te veçanta me kerkese te projektit ose te supervisorit perdoren edhe kundralvalvolat qe jane valvola te cilat lejojne levizjen e ujit vetem ne nje drejtim. Keto duhet te vendosen ne tubin e thithjes se pompave apo ne tubin e dergimit te tyre. Gjithashtu ato vendosen ne hyrje te ndertese per te bere bllokimin e ujit qe futet.

Ato jane te tipit me porte, e cila me ane te nje çerniere hapet vetem ne nje drejtim. Ne rast se uji rrjedh ne drejtim te kundert me ate qe kerkohet, behet mbyllja e saj me ane te çernieres.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre ne objekt duhet te behen sipas kerkesave teknike te supervisorit dhe te projektit.

Nje model i valvoles qe do te perdoret se bashku me çertifikaten e cilesise, çertifikaten e origjines, çertifikaten e testimimit dhe te garancise do t'i jepet per shqyrtim Supervizorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt.

3.8 Pajisjet Hidrosanitare

3.8.1 WC dhe kaseta e shkarkimit

Ne ambientet e larjes apo dhomat e tualetit parashikohet edhe vendosja e WC-ve. Ato jane me material porcelani me te dhenat e standarteve teknike nderkombetare dhe duhet te percaktohen ne projekt nga projektuesi. Ato mund jane te tipit oriental.

WC-ja duhet te siguroje percjellshmeri te larte te ujrave, rezistence ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtësi gjate punes ne to dhe mundesi te thjeshta riparimi.

WC-ja lidhet me tubat e shkarkimit te ujrave me ane te tubit ne forme sifoni. Tubi i lidhjes se WC me tubat e shkarkimit duhet te jete PVC me te njejtat karakteristika teknike te tubave te shkarkimit te ujrave. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te WC (zakonisht ato jane 100-110 mm).

WC-ja lidhet me sistemin e furnizimit me uje me ane te kasetes se shkarkimit e cila mund te instalohet ne mur e ndare nga WC-ja. Kjo varet nga lloji i ketyre pajisjeve. Kaseta e shkarkimit vendoset ne lartesine rreth 1,5 m lart nga dyshemeja. Ajo mund te jete porcelani, metalike ose plastike. Lloji i materialit te saj duhet te percaktohet ne projekt. Tubi i shkarkimit fiksohet ne mur me fasheta te forta xingato, me vida dhe tapa me fileto ne çdo 50 cm.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e WC duhet te behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit. Bashkimi i WC-ve me tubat e shkarkimit duhet te behet me mastik te pershtatshem per tuba PVC, i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

Nje model i WC qe do te perdoret se bashku me çertifikaten e cilesise, çertifikaten e origjines, çertifikaten e testimimit dhe te garancise do t'i jepet per shqyrtim Supervizorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt. Te dhenat teknike te WC duke perfshire edhe modelin e tij, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, viti i prodhimit, etj duhet te jepen ne katalogun perkates qe shoqeron mallin. Supervisor mund te beje testimime plotesuese per te dhenat fizike-mekanike te tyre.



3.8.2 Lavamanet

Ne ambientet e larjes apo dhomat e tualetit, gjithmone duhet te parashikohen pajisjet hidrosanitare perkatese (lavamanet) te cilat sherbejne si vende per larjen e duarve dhe fytyres. Lavamanet mund te jene metalike, porcelani, muri tulle i suvatuar e veshur me pllaka ose te montuar ne veper. Lloji i materialit perberes te tyre duhet te percaktohet ne projekt nga projektuesi.

Lavamanet duhet te sigurojne percjellshmeri te larte te ujrave, rezistence ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, eliminim te zhurmave gjate punes, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtesi gjate punes ne to dhe mundesi te thjeshta riparimi.


Lavamanet e porcelanit dhe mbeshtetesja e tyre fiksohen ne mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa nderprere veshjen me pllaka te murit. Pas fiksimit te saj ne mur duhet te behet vendosja e rubinetave me tunxh te kromuar mbi lavaman dhe bashkimi i lavamanit me tubat e kanalizimit te sifonit dhe tubat e shkarkimit te ujrave. Njekohesisht lavamani duhet te pajiset edhe me pileten e tij metalike. Pileta duhet te vendoset ne pjesen me te ulet te siperfaqes se gropes mbledhese ku eshte hapur nje vrime me permasat e piletes. Lavamani ka nje grope mbledhese me permasa 40/60 x 36-45 cm ne varesi te llojit dhe modelit te zgjedhur. Permasat e lavamanit jane ne varesi te llojit dhe modelit te tyre Lavamanet vendosen ne lartesi 75-85 cm sipas kerkeses se projektit dhe Supervizorit. Distanca horizontale e vendosjes se tyre nga pajisjet e tjera hidrosanitare (bide,WC, etj) duhet te jete te pakten 30 cm

Lavamanet lidhen me tubat e shkarkimit te ujrave me ane te piletes, tubit ne forme sifoni prej materiali PVC-je. Lidhja e mesiperme mund te behet me tridegeshe te pjerreta nen nje kend 45 ose 60 grade. Tubi i lidhjes duhet te jete PVC me te njejtat karakteristika teknike te tubave te shkarkimit te ujrave. Gjatesia e ketyre tubave eshte 20 - 40 cm. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te piletes ku jane vendosur.

Lavamanet lidhen me sistemin e furnizimit me uje me ane te dy tubave fleksibel me gjatesi 30 - 50 cm dhe diameter 1/2 ", te cilet bejne lidhjen e rubinetit me tubat e furnizimit me uje te ngrohte dhe ujit te zakonshem. Ne vendin e lidhjes se rubinetit me lavamanin duhet te vendosen gomina te pershtatshme, per te mos bere lejimin e rrjedhjes se ujrave.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre ne objekt behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit. Bashkimet e lavamanit me tubat e shkarkimit duhet te behen me tubat perkates dhe me mastik te pershtatshem per tuba PVC i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

Nje model i lavamanit qe do te perdoret sebashku me çertifikaten e cilesise, çertifikaten e origjines, çertifikaten e testimi dhe te garancise do ti jepet per shqyrtim Supervizorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt. Supervisor mund te beje testim plotesues per te dhenat fizike-mekanike te tyre. Ne figuren e meposhtme paraqitet nje lavaman porcelani, i cili eshte inkastruar ne mur.



3.8.3 Rubinetat

Rubinetat janë pajisje të veçanta që përdoren për kontrollin e rrjedhjes në tubacionet e ujit. Ato vendosen në pajisjet hidrosanitare perkatese (lavamanë, lavapjata ose bide) dhe mund të jenë të thjeshta (përdoren vetëm për ujë dhe pijshëm) ose të përbëra (përdoren për sistemet e ujit të ftohtë dhe të ngrohtë). Me anë të rubinetave mund të ndryshohet madhësia e prurjes që del në pajisjen hidrosanitare si dhe mund të bëhet edhe rregullimi i temperaturës së ujit që përdoret. Rubinetat mund të jenë me material bronxi, gize ose të nikeluara. Ato janë të tipit me sferë ose porte.

Grupi i Rubinetes është tip me lidhje tubi, ose dy lidhje rrethore, i cili përbëhet prej pjesëve të mëposhtme:

- Trupi prej gize ose bronxi. Forma dhe lloji i trupit të rubinetes janë të ndryshme. Ngjyra, forma dhe tipi janë të përcaktuara në projekt ose duhet të përcaktohen nga Investitori.
- Disku ose sfera, që duhet të sigurojë mbylljen dhe hapjen e rubinetes për ujë të ftohtë ose të ngrohtë duke bërë edhe rregullimin e sasise që del nga rubineta. Ato janë me material çeliku ose bronxi dhe duhet të jenë rezistente ndaj korrozionit, goditjeve mekanike, etj.
- Leva e cila lidhet me boshtin e rrotullimit dhe realizon hapjen ose mbylljen e diskut.
- Filtri i ujit i cili vendoset me filetimit në dalje të rubinetes dhe siguron pastrimin e ujit nga lëndë të ndryshme minerale apo kriprat që shoqërojnë ujë dhe pijshëm.
- Tubat fleksibël me gjatësi 30-50 cm të cilët bëjnë lidhjen e rubinetes me tubat e furnizimit me ujë. Tubat fleksibël kanë diametrimin 1/2" ose 3/8" në varesë të llojit të rubinetes dhe të tubave.

Në vendin e bashkimit të rubinetave me pajisjen hidrosanitare dhe me tubat lidhës duhet të vendosen gominat perkatese të cilat nuk lejojnë rrjedhjen e ujit.

Rubinetat duhet të sigurojnë rezistencë perfekte ndaj korrozionit, rezistencë ndaj agjentëve kimikë, pamje sa më të mira, mundësi të thjeshtë riparimi, jetëgjatësi dhe qëndrueshmëri ndaj goditjeve mekanike. Rubinetat duhet të përballojnë një presion 1,5 here më tepër se vetë tubat e linjes. Ato duhet të përballojnë një presion minimal prej 10 atm.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e rubinetave në pajisjet hidrosanitare të bëhen sipas kërkesave teknike të supervizorit dhe të projektit.

Një model i rubinetes së duhur që do të përdoret së bashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimit dhe të garancisë do të jepet për shqyrtim Supervizorit për një aprovim para se të vendoset në objekt. Të dhënat mbi diametrimin e jashtëm të rubinetit, modelin e tij, presionin, emrin e prodhuesit, standartin që i referohet, viti i prodhimit, etj duhet të jepen në katalogun perkatesë që shoqëron mallin. Supervizori mund të bëjë teste plotësuese për cilësinë e tyre si dhe presionin që durojnë pas instalimit (Testi i presionit bëhet me 1.5 here të presionit të punës).

4. SISTEMI I SHKARKIMIT TE UJRAVE TE ZEZA

4.1 Dimensionimi

Dimensionimi dhe projektimi i te gjithë komponenteve dhe aksesoreve te sitemit te shkarkimit te ujrave te zeza do te kryhet duke marre ne konsiderate te gjithë elementet te percaktues si me poshte:

- Skema e shpërndarjes (shkarkimet e brendshme te pajisjeve H/S, kolonat, kolektoret, pusetat);
- Percaktimi i fluksit nominal te shkarkimeve per çdo pajisje H/S;
- Percaktimi i fluksit projektues te shkarkimeve;
- Vizatimet dhe dimensionimet e shkarkimeve te brendshme te ujrave te zeza;
- Vizatimet dhe dimensionimet e shkarkimeve te kolonave te ujrave te zeza;
- Vizatimet dhe dimensionimet e kolonave te balancimit te presionit te ujrave te zeza;
- Vizatimet dhe dimensionimet e kolektoreve te shkarkimeve te brendshme;
- Vizatimet dhe dimensionimet e tubacioneve te shkarkimit te ujrave te shiut;
- Vizatimet dhe dimensionimet e kolektoreve te jashtem;
- Vizatimet dhe dimensionimet e pusetave te ujrave te zeza.

Dimensionimi i tubove do te jete ne vartesi te fluksit te llogaritur te ujrave te zeza, shpejtesise se qarkullimit dhe pjeresise se tyre etj. Shpejtesia duhet te jete 1.0-1.2 m/sec dhe pjeresia e tubove ne kufijte (0.5 – 0.8) %. Gjatesia e tubove do te jete 6-10 m. Diametrat dhe trashesite do te jene ne perputhje me te dhenat e projeketit. Ne diametrat e jashtem te çdo tubi duhet te jene te stampuar karakteristikat sikurse presioni, fabrika prodhuese, viti i prodhimit etj.

4.2 Materialet e tubave

Per shkarkimet e ujrave brenda ambienteve do te perdoren tuba plastike RAU – PP (polipropilen i termostabilizuar ne temperature te larta) qe plotesojne te gjitha kerkesat e cilesise sipas standartit EN 1451 (Kerkesa per testimin dhe kualitetin tubove). Ata jane disenjuar ne perputhje me standartin EN 12056.

Keto tuba duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti, instalim te thjeshte dhe te shpejte si dhe jetegjatesi mbi 30 vjet.



Tubat e shkarkimit duhet te vendosen ne te gjithë lartesine e nderteses, ne formen e kollonave, ne ato njeje sanitare ku aparatet jane me te grupuara dhe mundesisht sa me afer atyre njejeve qe mbledhin me shume ujera te ndotura dhe ndotje me te medha.

Tubat e shkarkimit lidhen me pajisjet sanitare ose grup pajisjesh ne çdo kat me ane te tubave te dergimit. Lidhja e tubave te dergimit me kollonat e shkarkimit duhet te behet me tridegeshe te pjerreta nen nje kend 45 ose 60 grade. Tubat e dergimit mund te shtrohen anes mureve, mbi ose nen solete duke mbajtur parasysh kushtet e caktuara per montimin e rrjetit te brendshem te kanalizimeve. Gjatesia e ketyre tubave nuk duhet te jete me teper se 10 m. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te pajisjeve sanitare qe jane vendosur.

Çdo kollone vertikale e shkarkimit pajiset me pika kontrolli te cilat duhet te vendosen ne çdo dy kate duke filluar nga pjesa e poshtme e kollones.

Tubat e shkarkimeve qe do te perdoren ne ambientet e jashtme, jante tuba te PP te trullosur, me specifikime teknike si me poshte:



Specifikimet teknike:

Materiali: PP (*Polipropilen*) në të zezë dhe të verdhë

Përmasat:

- D [mm]: 125-600

- L [m]: 3, 6

Temperatura maksimale operative [° C]: 95

Klasa tub ngurtësi [kN / m²]: SN 4, SN 8

4.3 Rakorderit e tubave

Per lidhjen e tubave te shkarkimit me njeri tjetrin si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do te perdoren rakorderite perkatese me material plastik RAU – PP, qe plotesojne te gjitha kerkesat e cilesise sipas standartit EN 1451 (Kerkesa per testimin dhe kualitetin tubove).

Keto rakorderi (pjesë bashkuese) duhet te sigurojne rezistence ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti dhe instalim, te thjeshte dhe te shpejte.



Permasat (diametri) e tyre do te jene ne funksion te sasise llogaritese te ujit te ndotur, llojit te pajisjeve sanitare, shpejtesise se levizjes se ujit dhe diametrave te tubave perkates. Gjate llogaritjeve, shpejtesia e levizjes se ujit duhet te merret 1-2 m/sek kurse shkalla e mbushjes do te jete 0.5-0.8 e seksionit te tubit.

Diametri dhe spesori i tyre duhet te jene sipas te dhenave ne vizatimet teknike. Te dhenat mbi diametrin e jashtem, gjatesite, presionin, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, viti i prodhimit, etj. duhet te jepen te stampuara ne çdo rakorderi.

Diametri i rakorderive duhet te jete i njejte me diametrin e tubit te shkarkimit ku do te lidhet dhe ne asnje menyre me i vogel se tubi me i madh i dergimit te ujrave te ndotura qe lidhet me te. Ne rastet e ndryshimit te diametrin te tubave te shkarkimit dhe te dergimit, rakorderite duhet t'i pershtaten secilit prej tyre.

4.4 Piletat

Per shkarkimet e ujrave te dyshemeve do te perdoren piletat RAU – PP, qe plotesojne te gjitha kerkesat e cilesise sipas standartit EN 1451 (Kerkesa per testimin dhe kualitetin tubove).

Piletat mund te jene me material plastik, inoksi dhe bronxi.

Piletat duhet te sigurojne percjellshmeri te larte te ujrave, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, mundesi te thjeshta riparimi, transporti dhe bashkimi.

Piletat e shkarkimit duhet te vendosen ne pjesen me te ulet te siperfaqes ku do te mblidhen ujrat. Zakonisht ato nuk vendosen ne afersi te bashkimit te dyshemese me muret, por sa me afer mesit te dyshemese.

Piletat e shkarkimit lidhen me kollonat e shkarkimit me ane te nje tubi PP. Lidhja e piletave me kollonat e shkarkimit mund te behen me tridegeshe te pjerreta nen nje kend 45 ose 60°. Tubi i lidhjes duhet te jete PVC me te njejta karakteristika teknike te tubave te shkarkimit te ujrave. Gjatesia e ketyre tubave eshte 20 - 30 cm. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te piletes ku jane vendosur. Ne rastet e ndryshimit te dimaterit te piletes me ate te tubit te dergimit do te perdoren reduksionet perkatese.

4.5 Pusetat e ujrave te zeza

Te gjitha tipet e pusetave te lartepermendura mund te jene me mure te tilla me elemente te parafabrikuara betoni, ose me beton te derdhur ne vend.

Materiali nga i cili eshte prodhuar si korniza ashtu edhe kapaku duhet te jene prej gize.

Pusetat duhet te plotesojne kerkesat e meposhtme teknike:

- Ngarkesen e mbajtjes, te jashtme;
- Presionin e dheut;
- Presionin e ujit.

Dimensionet e pusetave kalkuloohen ne funksion te prurjeve jane percaktuar nga projektuesi ne vizatimet perkatese.



Gjithashtu edhe dimensionet e kolektoreve qe shkarkojne ujrat e zeza dhe ato te shiut jane kalkuluar dhe dimensionuar ne funksion te prurjeve dhe materiali i tyre eshte perzgjedhur PE i rudhosur ne siperfaqen e jashteme dhe i lemuar ne ate te brendshme me dimensione qe variojne nga 200 - 250 mm.

4.6 Kullimi i ujrave te shiut

Nje pike e rendesishme gjate projektimit te nje ndertimi eshte edhe kullimi i ujrave te shiut, qe grumbullohen nga çatite ose tarracat.

Ujrat e shiut do te kene nje kanalizim te ri perreth ndertese dhe me pas duhet te kullojne ne kanalizimin e pergjithshem te godines e me tej ne ate ekzistues te zones .

Çative, ballkoneve, taracave dhe elementeve te tjera te ndertimit, duhet tu hiqet uji me nje sistem te perbere prej pjerrësish drejt piletave te shkarkimit dhe me tej mblidhen neper tuba brenda ndertesës.

4.7 Pusetat e ujrave te shiut

Per grumbullimin e ujrave te shiut do te perdoren puseta te tipit mbledhese me konstrukcion te parafabrikuar polietilene te papershkueshem nga uji dhe me kapak gize. Ato per nga forma e ndertimit mund te jene katrore, drejtkendeshe ose rrethore ndersa nga menyra e organizimit te tyre mund te jene me nje dhome me dy ose me shume dhoma.

Pusetat e ujrave te shiut duhet te jene ne forme rrethore me thellesi jo me pak se 60 cm, mbuluar me kapak zgare hekuri ose gize. Te çarat me kapakun prej zgare jane nga 25 deri 35 mm per te ndaluar plehrat si dhe per te mundesuar kullimin e ujrave.



Pusetat e hyrjes material PE – polietilene, menyra e prodhimit me metodën e derdhur me rotacion.

Inspektimi i pusetave PE tregtohet nga ITC-ja, duhet te jenë prodhuar në përputhje me standarte evropiane Pren 13.598 cili përfshin sistemet e tubacioneve plastike për kullimit dhe kanalizimit. Baza e mirë është ndërtuar në përputhje me DIN V 4.034-1.

Karakteristikat pozitive te pusetave PE, jane si me poshte:

- Objektet prodhuar pa përdorimin e presionit janë gjithmon të përsosura;
- Nuk ka saldime;
- Eshte e mundur edhe të prodhohen objekte të madhësisë të madha;
- Aftësia për të prodhuar objekte të çdo formë.

5. SISTEMI I AJRIT TE KONDICIONUAR

5.1 Kërkesa te pergjithshme

Referenca

Me poshtë jepen referencat e standardeve qe janë marre ne konsiderate gjate hartimit te projektit.

Këto i referohen:

Ligjet dhe normat e aplikuara ne Shqipëri

Normat evropiane

DIN EN ISO 1632	2000	Matja e nivelit te presionit te zhurmave nga pajisjet sherbimit ne ndertesa, metodat inxhinierike
DIN 4755	2001	Instalimet e kaldajave, kerkesat e sigurise
DIN EN 12828	2003	Sistemet e ngrohjes ne ndertesa
DIN EN 13831	2000	Enet e zgjerimit te mbyllura
DIN EN 14336	2002	Sistemet ngrohjes ne ndertesa, instalimi dhe miratimi teknik.
VDI 2035	1996	Parandalimi i demtimeve ne sistemet hidraulike te ngrohjes.
DIN EN 1057	1996	Tubot Cu ne sistemet e ngrohjes dhe ujit sanitar.
DIN EN 12449	1999	Tubo Cu per perdorim te pergjithshem.

5.2 Konditat e jashteme te projektimit

Konditat e komfortit termoigrometrik (mireqenia fiziologjike) qe mund te sigurojme brenda teatrit jane çështja me kryesore dhe jane ne vartesi te destinacionin te perdorimit te ambienteve. Te dhenat e meposhteme jane perdorur si referenca per projektin.

Vendndodhja

Maliq

Gjersia gjeografike

40 36

Per periudhen e Ngrohjes - Dimer

Grade dite te ngrohjes

2273 grade-dite

Periudha e ngrohjes

22/11 – 27/03

Ditet e ngrohjes

126 dite

Temperatura e jashteme e projektimit

-10 °C

Lageshtia relative

90 %

Per periudhen e freskimit – Vere

Temperatura maksimale e muajit te nxehte

36 °C

Temperatura mesatare e muajit te nxehte

35 °C

Lageshtia relative mes. e muajit te nxehte

55 %

Sistemi i ngrohjes/ ftohjes se godines eshte planifikuar te jete hidronik me ngrohje/ ftohje me Fan-Coila dhe burimi i energjise do te sigurohet nga Chilleri version pompe e nxehtesise per ujin e ngrohje dhe te ftohte dhe per periudhen e dimrit me kaldaje gazi. Uji i ngrohje/ ftohte do te shperndahet nga rrjeti i tubove qe do te furnizojne te gjithe terminalet ne ambientet e godines.

5.3 Karakteristika arkitektonike

Per nga natyra e funksionaliteti, kjo ndertese eshte e ndare ne disa zona kryesore, te cilat per nga natyre e tyre kane ushtrohen aktivite qe dallojne nga njeri-tjetri, por qe kane te njejtin qellim te perbashket per sa i perket sigurimit te nje komoditeti normal per procesin e funksionimit. Keto kerkesa jane parapare ne propocion me standartet e jeteses si dhe me ndikimin e tyre ne koston e ndertimin e godines.

Ambientet dhe strukturat e godines jane te ndryshme ne funksion te dimensionimit te tyre dhe lokalizimit ne projekt. Konfigurimi eshte kompozuar ne tre zona te ndryshme nga pikpamja e konstruksionit, funksionalitetit dhe pajisjeve te instaluar .

- Salla kryesore e teatrit
- Dhoma serverësh
- Salla takimesh
- Zyrat;
- Banjot;
- Korridoret dhe ambiente ndihmese.
- Ambienti i shërbimit

5.4 Humbjet e nxehtesise

Per te anlizuar ne menyre te kujdeseshme humbjet e nxehtesise jane konsideruar te gjithë faktoret qe influencojne per shkak te orintimit me horizontin, afersia me ambientet, karakteristikat termofizike te mureve rethues, dritareve, dyshemese, tavanit, dhe çatise prej druri etj.

Ngarkesat termike te nxehtesise influencohen edhe nga popullimi i ambienteve, ndriçimi, ventilimi i ajrit etj, te cilat jane konsideruar gjate llogaritjeve termike te ndërtesës.

Ngarkesat termike ne baze te natyres se faktorit dhe influences ne bilancin termik perlloragriten si humbje ose si shtese termike, por gjithsesi ato qe influencojne ne menyre te drejteperdrejte jane:

- Numri i personave prezent;
- Aktiviteti i tyre fizik;
- Sipërfaqja e ujit te pishines
- Niveli i ndricimit dhe aparatet elektrike te instaluar;
- Niveli i rrezatimit diellor;
- Infiltrimet e ajrit nga dyer-dritare (ventilimi natyral).
- Ventilimi mekanik

Te gjitha te dhenat e mesiperme kane sherbyer per klakulime nepermjet programit kompjuterik (software – it) te humbjeve ne stinen e dimrit dhe te veres si dhe specifikimet teknike te pajisjeve qe duhen përdorur.

Ngarkesat ne impiantin e kondicionimit kane nje specifike te cilat varet nga fakti qe jo te gjithë ambientet jane te ngarkuara ose te perdorura ne menyre konstante. Keshtu ky fakt kerkon ndertimin e grafikut te perqendrimit ose grafikun e veprimit te impiantit te kondicinimit i cili ka te beje me tipologjine e impiantit dhe shkallen e automatizimit, te kontrollit dhe komandimit te tij.

Te gjithë keto faktore siç kuptohet jo gjithnje paraqiten ne te njejten vlere dhe me te njejten influence prandaj konsiderohen si ngarkesa (humbje) termike variable.

Ndersa ne funksion te nderteses nga pikepamja arkitektonike, materialeve ndertimore etj, rezultojne humbje termike konstante (humbjet nga muret, dritret, dyert, dyshemeja, soleta e tavanit, etj.)

Keto faktore kane influence konstante ne ngarkesat (humbjet) termike dhe si te tilla zgjidhen me mjaft kujdes ne menyre qe kostoja e ndertimit te impiantit mos kaloje qellimin e kursimit te humbjeve energjike, si dhe nga ana tjetere te mos mbidimensionohet impanti i kondicionimit.

Nga pikpamja e kapacitetit termik te pajisjve nenvizojme se kapacitet per pikun e ngarkeses variojne ne menyre te konsiderueshme gjate dites bazuar ne variacionin e okupimit te ambienteve. Per te shmanguar super dimensionimin e kapaciteteve te pajisjeve eshte analizuar paraprakishte profili i okupimit te zonave si dhe parashikimi paraprak i konsumit energjetik.

5.5 Burimi i energjise

